Një model i tubacioneve të furnizimit me ujë të ngrohtë, rakordërive përkatëse, materialit termoizolues së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë do ti jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset ne objekt. Supervisori mund të bëjë testime plotësuese për të dhënat fizike - mekanike - termike rrjedhje të mundshme si dhe presionin dhe temepraturën që durojnë tubat.

Xhunto antivibruese

Xhunto antivibruese eshte e perbere nga nje perzierje gomash me baze sintetike duke shtuar edhe pjese te veçanta. Ato perdore per te reduktuar vibrimet dhe zhurmat pergjate linjave te tubave hidraulik, per te kompesuar diletacionin e tubave si dhe per te zbutur grushtet hidraulike etj

Codice	Compensazione*					Ingombro*	
	D	h+	h-	α ±	e ±	A	Lt
657.04.00	1/2"	10	10	35	5	18	170
657.05.00	3/4"	10	10	30	5	20	180
657.06.00	1"	10	10	25	6	20	200
657.07.00	1"1/4	15	15	30	10	20	220
657.08.00	1"1/2	20	20	25	10	20	240
657.09.00	2"	20	20	20	10	25	240

*Quote in mm.



Codice	Compensazione*					Ingombro*			
	D	h+	h-	α ±	e ±	De	Dr	s	Lt
658.10.00	65	20	20	20	10	185	145	24	150
658.11.00	80	20	20	25	10	200	160	24	160
658.13.00	100	20	20	25	10	220	180	26	170
658.14.00	125	25	25	4	6	250	210	28	250
658.15.00	150	25	25	4	6	285	240	28	250

*Quote in mm.



Procurement Albania
Public Health Sector

Filter uji me rrjet

Filtri sherben per filtrimin mekanik te ujit duke parandaluar fenomenin e korrozionit lokal qe mund te shkaktohet nga materiale solide, grimca rere, jone hekuri etj qe permban uji .Temperatura e punes -20
÷110 ° C, me lidhje mashkull-femer

Valvol moskthimi

Valvola e moskthimi sherben per moskthimin e fluidit mbrapsht. Materiali bronx, me lidhje mashkull-femer . Temperatura maksimale e punes 90°C, presioni maksimal i punes 10 bar.

Reduktor presioni

Reduktor presioni sherben per te rregulluar presionin sipas vlerave te kerkuara. Trup bronxi , me fishek me filetim, me lidhje mashkull -femer. Presioni maksimal 25 bar temperatura e punes 80 °C

Max inlet pressure:	**25 bar**
Field of action (outlet pressure):	**0,5 - 6 bar (1,5 – 6 bar)[1]**
Max temperature of use:	**80° C** **130° C[1]**
Threading of connection:	**ISO 228/1**
Tested according to rules:	**DIN EN 1567**
Suitable fluids:	**Water, air.** **Water, air, diesel oil.[1]**
Reduction rate:	**5 : 1 ***

1.3 Shkarkimet e Ujrave te Zeza

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sitemit te shkarkimit te ujrave te zeza dhe ato te shiut do te kryhet duke marre ne konsiderate te gjithe elementet te percaktues si me poshte:

- Skema e shpërndarjes (shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S, kolonat, kolektoret, pusetat);
- Percaktimi i fluksit nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- Percaktimi i fluksit projektues te shkarkimeve;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te brendshme te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te kolonave te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolonave te balancimit te presionit te ujrave te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te shkarkimeve te brendshme;
- Vizatimet dhe dimensionimet e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te shiut;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te jashtem;
- Vizatimet dhe dimensionimet e pusetave te ujrave te zeza dhe te shiut.

Dimensionimi i tubove do te jete ne vartesi te fluksit te llogaritur te ujrave te zeza apo te shirave, shpejtesise se qarkullimit dhe pjeresise se tyre etj. Shpejtesia duhet te jete 1.0-1.2 m/sec dhe pjeresia e tubove ne kufijte (0.5 – 0.8) %.
Gjatesia e tubove do te jete 6-10 m. Diametrat dhe trashesite do te jene ne perputhje me te dhenat e projeketit. Ne diametrat e jashtem te çdo tubi duhet te jene te stampuar karakteristikat sikurse presioni, fabrika prodhuese, viti i prodhimit etj.

Open Procurement Albania

1.3.1 Tubat e shkarkimit

Per shkarkimet e ujrave brenda ambienteve do te perdoren tuba plastike RAU – PP (polipropilen i termostabilizuar ne temperature te larta) qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove). Ata jane disenjuar ne perputhje me standartin EN 12056.

Public Health Sector

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesisht sa me afer atyre nyjeve qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha.
Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh ne çdo kat me ane te tubave te dergimit. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit duhet te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubat e dergimit mund te shtrohen anes mureve, mbi ose nen solete duke mbajtur parasysh kushtet e caktuara per montimin e rrjetit te brendshem te kanalizimeve.
Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

Çdo kollone vertikale e shkarkimit pajiset me pika kontrolli te cilat duhet te vendosen ne çdo dy kate duke filluar nga pjesa e poshtme e kollones.

Tubat e shkarkimeve qe do te perdoren ne ambientet e jashtme, jante tuba te PP te trullosur, me specifikime teknike si me poshte:

Specifikimet teknike:

Materiali: PP (Polipropilen) në të zezë dhe të verdhë
Përmasat:
- Martohem me [mm]: 150-600 - L [m]: 3, 6
Temperatura maksimale operative [° C]: 95
Klasa tub ngurtësi [kN / m2]: SN 4, SN 8

Open Procurement Albania
Public Health Sector

9.3.2 Rakorderite per tubacionet e ujrave te zeza

Per lidhjen e tubave te shkarkimit me njeri tjetrin si dhe me pajsijet sanitare apo grupet e tyre do te perdoren rakorderite perkatese me material 56ad hi56 RAU – PP, qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove).

Keto rakorderi (pjese bashkuese) duhet te sigurojne rezistence ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe instalim, te thjeshte dhe te shpejte.

Permasat (56ad hi56ic) e tyre do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te ndotur, llojit te pajisjeve sanitare, shpejtesise se levizjes se ujit dhe diametrave te tubave perkates. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes se ujit duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do te jete 0.5-0.8 e seksionit te tubit.

Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standardit qe i referohen, viti i prodhimit, etj. duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejte me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnje menyre me i vogel se tubi me i 56ad hi dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet

e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

1.3.3 Tubat e ajrimit

Tubat e ajrimit jane zgjatim ne pjesen e siperme te kollonave te shkarkimit dhe duhet te nxirren 70 – 100 cm me lart se pjesa e siperme e çatise ose tarraces se nderteses.

Ato duhet te sherbejne per ajrimin e rrjetit te brendshem dhe te jashtem te kanalizimeve. Ky ajrim eshte i domosdoshem sepse me ane te tij behet e mundur largimi i gazrave te krijuara ne kollonat e shkarkimit si dhe i avujve te ndryshem qe jane te demshem per jeten e banoreve.
Gjithashtu, tubat e ajrimit do te sherbejne per te bashkuar kollonat e kanalizimeve me atmosferen per te menjanuar nderprerjen e punes se sifoneve ne pajisjet hidrosanitare.

Tubat e ajrimit duhet te kene diametrin e brendshem DN 75 dhe ne maje te tubave te ajrimit duhet te vendoset nje kapuç i cili pengon hyrjen ne tub te ujrave te shiut dhe debores si dhe permireson ajrimin e kollones se shkarkimit.

Per te permiresuar dhe shpejtuar ajrimin e kollonave te shkarkimit (ne varesi te rendesise se objektit dhe kerkesave te projektit, ne tubat e ajrimit, mund te montohen edhe pajisje elikoidale te cilat bejne largimin e shpejte te gazrave dhe avujve qe vine nga kollonat e shkarkimit.

1.3.4 Piletat

Per shkarkimet e ujrave te dyshemeve do te perdoren piletat RAU – PP, qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove.

Piletat mund te jene me material plastik, inoksi dhe bronxi.
Piletat duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi.

Piletat e shkarkimit duhet te vendosen ne pjesen me te ulet te siperfaqes ku do te mblidhen ujrat. Zakonisht ato nuk vendosen ne afersi te bashkimit te dyshemese me muret, por sa me afer mesit te dyshemese.

Piletat e shkarkimit lidhen me kollonat e shkarkimit me ane te nje tubi PP. Lidhja e piletave me kollonat e shkarkimit mund te behen me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60°. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 30 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur. Ne rastet e ndryshimit te dimaterit te piletes me ate te tubit te dergimit do te perdoren reduksionet perkatese.

Piletat per shkarkimet e ujrave te dyshemeve dhe duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi; sipas standartit UNI EN 1451

- Materiali PE
- Dimensioni DN 40/50
- Pesha 0.218 kg
- Thellësia e inkasos 57 mm

1.3.5 Pusetat

Te gjitha tipet e pusetave te lartepermendura mund te jene me mure te tilla me elemente te parafabrikuara betoni, ose me beton te derdhur ne vend.

Materiali nga i cili eshte prodhuar si korniza ashtu edhe kapaku duhet te jene prej gize.
Pusetat duhet te plotesojne kerkesat e meposhtme teknike:

- Ngarkesen e mbajtjes, te jashtme;
- Presionin e dheut;
- Presionin e ujit.

Dimensionet e pusetave kalkulohen ne funksion te prurjeve jane percaktuar nga projektuesi ne vizatimet perkatese.

Gjithashtu edhe dimensionet e kolektoreve qe shkarkojne ujrat e zeza dhe ato te shiut jane kalkuluar dhe dimensionuar ne funksion te prurjeve dhe materiali i tyre eshte perzgjedhur PE i rudhosur ne siperfaqen e jashteme dhe i lemuar ne ate te brendshme me dimensione qe variojne nga 200 - 250 mm.

1.4 Kullimi i ujrave te shiut

Nje pike e rendesishme gjate projektimit te nje ndertimi eshte edhe kullimi i ujrave te shiut, qe grumbullohen nga çatite ose tarracat.
Ujrat e shiut do te kene nje kanalizim te ri perreth ndertese dhe me pas duhet te kullojne ne kanalizimin e pergjithshem te shkolles e me tej ne ate ekzistues te zones .
Çative, ballkoneve, taracave dhe elementeve te tjera te ndertimit, duhet tu hiqet uji me nje sistem te perbere prej pjerrësish drejt puseve dhe me tej mblidhen neper tuba brenda nderteses.

1.4.1 Pusetat e ujrave te shiut

Per grumbullimin e ujrave te shiut do te perdoren puseta te tipit mbledhese me konstruksion te parafabrikuar polietileni te papershkueshem nga uji dhe me kapak gize. Ato per nga forma e ndertimit mund te jene katrore, drejtkendeshe ose rrethore ndersa nga menyra e organizimit te tyre mund te jene me nje dhome me dy ose me shume dhoma.

Pusetat e ujrave te shiut duhet te jene ne forme rrethore me thellesi jo me pak se 60 cm. Permasat jane 40 x 40, mbuluar me kapak zgare hekuri ose gize. Te çarat me kapakun prej zgare jane nga 25 deri 35 mm per te ndaluar plehrat si dhe per te mundesuar kullimin e ujrave.

Pusetat e hyrjes material PE – polietileni, menyra e prodhimit me metodën e derdhur me rotacion. Inspektimi i pusetave PE tregtohet nga ITC-ja, duhet te jenë prodhuar në përputhje me standarde evropiane Pren 13.598 cili përfshin sistemet e tubacioneve plastike për kullimit dhe kanalizimit. Baza e mirë është ndërtuar në përputhje me DIN V 4.034-1.

Karakteristikat pozitive te pusetave PE, jane si me poshte:

- Objektet prodhuar pa përdorimin e presionit janë gjithmon të përsosura;
- Nuk ka saldime;
- Eshte e mundur edhe të prodhohen objekte të madhësisë të madha;
- Aftësia për të prodhuar objekte të çdo formë.

1.4.2 Kunetat e drenazhimit

Sistemi i kullimit te ujrave te shiut pereth fushave te sportit do te behet me kuneta te parafabrikuar prej betony polimer referuar norms UNI EN 1433 me anti-zhurma, shasi integruar 8 mm.

Public Health Sector

Kapaku grile, materiali Gize en - GJS-500-7 (GGG).
Perdorimi per dranazhimin e fushave te sportit, gjerësi 13.5 cm, lartes 15.5 cm, klasa e ngrakeses nga klasa A15 për F900 sipas UNI EN 1433.

1.4.3 .Tub polietileni HDPE I rrudhosur

Karakteristikat teknike që duhet të kenë këta tuba janë:



- Rezistence të larte ndaj ngarkesave që mund të ushtrohen mbi të duke përfshire shtresën mbuluese të tyre si dhe peshën e makinave që kalojnë mbi rruge. Sipas standardit ISO9969 ngarkesa që duhet të përballojnë këto tuba duhet të varioje nga 2-16 KN/m2 .
- Rezistence të larte ndaj goditjeve duke eliminuar mundësinë e krijimit të çarjeve gjate transportit, ruajtjes dhe montimit sidomos në temperatura te ulëta. Këta tuba duhet të kenë një modul elasticiteti 1.0x103 MPa.
- Rezistence të lartë të rrjetit në vite. Duke mare ne konsiderate zgjerimet termike që ndodhin gjate ndryshimit të temperaturave, këta tuba duhet të kenë një koeficient zgjerimi termik linear (1.7±2)10-4 C-1 .
- Rezistence të lartë ndaj kimikateve të ndryshme dhe ndaj ndikimeve sizmike.

DN/OD	Толер. по дијаметар Diameter tolerance	ID	H	e5	e4	P	L_1	L_2
110		93.80	8.1	0.9	2.1	11.5	6.5	3
125		107	9	1.0	2.3	12.5	8.5	4.5
140		122	9.3	1.1	2.3	13.5	9.8	3.6
160		138	11	1.1	2.3	17	12.5	4.5
200		176	12	1.2	2.5	23	16	7
250	+/-2%	221	14.5	1.7	3.6	27	20	7
315		275	20	1.9	3.8	34.5	26	8.5
400		348	26	2.2	4.9	40.6	30.1	10.5
500		432	34	2.3	5.2	52	39	13
630		550	42	2.7	5.4	66	54	12
800		693	53.5	3.0	5.6	75	61	14
1000		860	70	3.3	7.6	105	86	19

1.5 Pajisjet Hidrosanitare

1.5.1 WC dhe kaseta e shkarkimit

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit parashikohet edhe vendosja e WC-ve. Ato jane me material porcelani me te dhenat e standarteve teknike nderkombetare dhe duhet te percaktohen ne projekt nga projektuesi. Ato mund te jene te tipit oriental ose alla frenga. Ne shkolla rekomandohen te tipit oriental WC, ku vendoset direkt ne dysheme dhe montohet llaç çimento sipas udhezimeve te dhena nga supervizori.

WC tip alla frenga perdoren ne kopshte dhe per personelin pedagogjik dhe antikapatet, fiksohen ne dysheme ose ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndeprere veshjen me pllaka te murit. Para fiksimit te tyre duhet te behet bashkimi me tubat e shkarkimit te ujrave. WC mund te jete me dalje nga poshte trupit te saj ose me dalje anesore ne pjesen e pasme te WC. Ne WC me dalje anesore tubi i daljes duhet te jete ne lartesine 19 cm nga dyshemeja.

Ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese eshte nje vrime me diameter minimal 90 mm. Pjesa e siperme e WC-se eshte ne forme vezake ose rrethore ne varesi te kerkeses se projektit, llojit dhe modelit te tyre. WC tip alla frenga jane me lartesi 38-40 cm dhe vendosen sipas kerkeses se

projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (Lavaman,bide, etj) duhet te jete te pakten 30 cm.

WC-ja duhet te siguroje percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtesi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te tubit ne forme sifoni. Tubi i lidhjes se WC me tubat e shkarkimit duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te WC (zakonisht ato jane 100-110 mm).

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me uje me ane te kasetes se shkarkimit e cila mund te instalohet direkt mbi WC ose ne mur e ndare nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i ketyre pajisjeve. Kaseta e shkarkimit vendoset ne lartesine rreth 1,5 m lart nga dyshemeja (rasti kur eshte e ndare). Ajo mund te jete porcelani, metalike ose plastike. Lloji i materialit te saj duhet te percaktohet ne projekt. Tubi i shkarkimit fiksohet ne mur me fasheta te forta xingato, me vida dhe tapa me fileto ne çdo 50 cm.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e WC duhet te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimi i WC-ve me tubat e shkarkimit duhet te behet me mastik te pershtatshem per tuba PVC, i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i WC qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimit dhe te garancise do t'i jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Te dhenat teknike te WC duke perfshire edhe modelin e tij, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen ne katalogun perkates qe shoqeron mallin. Supervisori mund te beje testime plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te tyre.

Ne figurat e meposhtme paraqiten dy tipe WC, ajo tip alla Turke dhe ajo tip alla Frenga.







1.5.2 Lavamanet

Ne ambientet e larjes apo dhomat e tualetit, gjithmone duhet te parashikohen pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamanet) te cilat sherbejne si vende per larjen e duarve dhe fytyres se femijeve. Lavamanet mund te jene metalike, porcelani, muri tulle i suvatuar e veshur me pllaka ose te montuar ne veper. Lloji i materialit perberes te tyre duhet te percaktohet ne projekt nga projektuesi.

Lavamanet duhet te sigurojne percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim te zhurmave gjate punes, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtesi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

Lavamanet e porcelanit dhe mbeshtetesja e tyre fiksohen ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa nderprere veshjen me pllaka te murit. Pas fiksimit te saj ne mur duhet te behet vendosja e rubinetave me tunxh te kromuar mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit te sifonit dhe tubat e shkarkimit te ujrave. Njekohesisht lavamani duhet te pajiset edhe me pileten e tij metalike. Pileta duhet te vendoset ne pjesen me te ulet te siperfaqes se gropes mbledhese ku eshte hapur nje vrime me permasat e piletes. Lavamani ka nje grope mbledhese me permasa 40/60 x 36-45 cm ne varesi te llojit dhe modelit te zgjedhur. Permasat e lavamanit jane ne varesi te llojit dhe modelit te tyre Lavamanet vendosen ne lartesi 75- 85 cm sipas kerkeses se projektit dhe Supervizorit. Distanca horizontale e vendosjes se tyre nga pajisjet e tjera hidrosanitare (bide,WC, etj) duhet te jete te pakten 30 cm

Lavamanet lidhen me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te piletes, tubit ne forme sifoni prej materiali PVC-je. Lidhja e mesiperme mund te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubi i lidhjes duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Gjatesia e ketyre tubave eshte 20 - 40 cm. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te piletes ku jane vendosur.

Lavamanet lidhen me sistemin e furnizimit me uje me ane te dy tubave fleksibel me gjatesi 30 - 50 cm dhe diameter 1/2 ", te cilet bejne lidhjen e rubinetit me tubat e furnizimit me uje te ngrohte dhe ujit te zakonshem. Ne vendin e lidhjes se rubinetit me lavamanin duhet te vendosen gomina te pershtatshme, per te mos bere lejimin e rrjedhjes se ujrave.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre ne objekt behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit. Bashkimet e lavamanit me tubat e shkarkimit duhet te behen me tubat perkates dhe me mastik te pershtatshem per tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave.

Nje model i lavamanit qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimit dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Supervisori mund te beje testime plotesuese per te dhenat fizike-mekanike te tyre.

Ne figuren e meposhtme paraqitet nje lavaman porcelani, i cili eshte inkastruar ne mur.



1.5.3 Rubinetat

Rubinetat jane pajisje te veçanta qe perdoren per kontrollin e rrjedhjes ne tubacionet e ujit. Ato vendosen ne pajisjet hidrosanitare perkatese (lavamane, lavapjata ose bide) dhe mund te jene te thjeshta (perdoren vetem per ujin e pijshem) ose te perbera (perdoren per sistemet e ujit te ftohte dhe te ngrohte). Per rubinetat e thjeshta mund ti referoheni zerit 95 (Saraçineskat). Me ane te rubinetave mund te ndryshohet madhesia e prurjes qe del ne pajisjen hidrosanitare si dhe mund te behet edhe rregullimi i temperatures se ujit qe perdoret. Rubinetat mund te jene me material bronxi, gize ose te nikeluara. Ato jane te tipit me sfere ose porte.

Grupi i Rubinetes eshte tip me lidhje tubi, ose dy lidhje rrethore, i cili perbehet prej pjeseve te meposhtme:

- Trupi prej gize ose bronxi. Forma dhe lloji i trupit te rubinetes jane te ndryshme. Ngjyra, forma dhe tipi jane te percaktuara ne projekt ose duhet te percaktohen nga Investitori.
- Disku ose sfera, qe duhet te siguroje mbylljen dhe hapjen e rubinetes per ujin e ftohte ose te ngrohte duke bere edhe rregullimin e sasise qe del nga rubineta. Ato jane me material çeliku ose bronxi dhe duhet te jene rezistence ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj
- Leva e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut.
- Filtri i ujit i cili vendoset me filetim ne dalje te rubinetes dhe siguron pastrimin e ujit nga lende te ndryshme minerale apo kriprat qe shoqerojne ujin e pijshem
- Tubat fleksibel me gjatesi 30-50 cm te cilet bejne lidhjen e rubinetes me tubat e furnizimit me uje. Tubat fleksibel kane diametrin 1/2" ose 3/8" ne varesi te llojit te rubinetes dhe te tubave

Ne vendin e bashkimit te rubinetave me pajisjen hidrosanitare dhe me tubat lidhes duhet te vendosen gominat perkatese te cilat nuk lejojne rrjedhjen e ujit.

Rubinetat duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence ndaj agjenteve kimike, pamje sa me te mire, mundesi te thjeshte riparimi, jetegjatesi dhe qendrueshmeri ndaj godtijeve mekanike. Rubinetat duhet te perballojne nje presion 1,5 here me teper se vete tubat e linjes. Ato duhet te perballojne nje presion minimal prej 10 atm.
Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e rubinetave ne pajisjet hidrosanitare te behen sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

Nje model i rubinetes se duhur qe do te perdoret sebashku me çertifikaten e cilesise, çertifikaten e origjines, çertifikaten e testimit dhe te garancise do ti jepet per shqyrtim Supervizorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt. Te dhenat mbi diametrin e jashtem te rubinetit, modelin e tij, presionin, emrin e prodhuesit, standartit qe i referohen, viti i prodhimit, etj duhet te jepen ne katalogun perkates qe shoqeron mallin. Supervizori mund te beje testime plotesuese per cilesine e tyre si dhe presionin qe durojne pas instalimit (Testi i presionit behet me 1.5 here te presionit te punes).

Public Health Sector

E. PUNIME ELEKTRIKE

Specifikime elektrike të veçanta

1.1.1 Aksesorët (të përgjithshme)

Aksesorët e instalimeve elektrike do të specifikohen në mënyrë të detajuar në pikat e mëposhtme të këtij seksioni.

Instalimi elektrik në përgjithësi duhet të jetë i plotë në të gjitha pikëpamjet (montimi dhe materiale) siç është treguar në projekte dhe skica, përshkruar me specifikimet ose udhëzimet e projektuesit.
Montimi duhet të përfshijë furnizimin me energji elektrike për të gjitha pajisjet elektrike të cilësuara dhe të ofruara, si edhe pajisjet e ofruara dhe të instaluara nga të tjerët.

Specifikimi përbën një plotësim të skicave të projektit. Në rast se ka përplasje midis skicave dhe specifikimeve, propozuesi (ofruesi) duhet të marrë një sqarim (të shkruar) ose interpretim nga projektuesi para se të shtrojë ofertën e tij (tenderin e tij).nëse nuk kërkohet një sqarim i tillë, interpretimi i inxhinierit në kantier (vendi i punës) do të jetë përfundimtar. Kontraktuesi duhet të vizitojë (kontrollojë) kantierin para se të vlerësojë qëllimin (fushën,sferën) e punës.

1.1.2 Percjellsa dhe kabllo

Të gjithe percjellsat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës.
Percjellsat duhet të jenë bakri të izoluar (veshur) me shtresë teke PVC për tu futur brenda tubave dhe linjave.
Izolimi i dejeve dhe këllëfi duhet të jenë me izolim të ngjyrosur për të identifikuar fazën dhe nulin.
Të gjitha rastet kur kabllot përfundojnë në një panel shpërndarës ose paisje elektrike etj, duhet lënë një sasi kablli të lirshëm për të lejuar në të ardhmen, zhveshjen e rilidhjes me terminalet pa shkaktuar tërheqje të tyre.
Zhveshja e izolimit në kabllot e izoluara me gome ose PVC duhet të kryhet duke përdorur vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo thikë.
Percjellsat duhet të jenë të ngjyrosura për identifikim. Blu-ja duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/jeshil dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtët përçues fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.
Të gjithe kabllot duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të kenë në anë etiketën dhe vulën e prodhuesit ose prova të tjera të origjinës dhe kontraktuesi duhet të marrë çertifikatat e testeve të përhershme të prodhuesit kundrejt një urdhri të dhënë, n.q.s kërkohet nga inxhinieri.

Ne nje tub zakonisht futet nje kabell,por ne se duam te fusim me shume ne kalimet vertikale,numri i kabllove që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kabllove dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ.

Kabllo fleksibël (me deje shumefijesh)

Të gjitha kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës.
Izolimi i kabllove duhet të durojë 600/1000 V tip-FG7(O)R.
Kabllot fleksibël duhet ti kenë dejet të ngjyrosura për identifikim. Blu-ja duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/jeshil dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Asnjë kabëll me seksion më të vogël se 1.5 mm² per ndricim dhe 2.5mm² per priza s'duhet të përdoret me instalim vetëm nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

-Nuk duhet te mbajne me teper se 80% te ngarkeses se tyre nominale korigjuar ne perputhje me kushtet e vendosjes

-Renia e tensionit nga fillimi i rrjetit te T.U. deri tek konsumatori me i larget nuk duhet te kaloje 4%,si per ndriçimin edhe per fuqine motorrike.

Tipet e kabllove e percjellesave qe do te perdoren jane:

-Kabell fleksibel multipolar,izolim gome etilenpropilenik,riveshur me PVC,tip

FG7(O)R 0.6/1kV me percjelles bakri te ripjekur,qe nuk perhapin flake dhe qe nuk permbajne halogjene ne tymin e djegjes,rrezja e ktheses 4-6 here diametrin,storcimi ne terheqje jo me teper se 5kg/mm².

-Percjellesfleksibel nje polar,prej bakri te ripjekur,izolim me rezine N07V-K, qe nuk perhapin flake, rrezja e ktheses 4 here diametrin,storcimi ne terheqje jo me teper se 5kg/mm².

Kabllot e vendosur ne kanalinat duhen fiksuar ,ne veçanti ne kalimet verticale dhe te pjerreta fiksimet duhet te jene me te dendura dhe te pershtateshme per te mbajtur peshen e tyre.Kabllot vendosen ne distance midis tyre per te siguruar ftohjen e tyre.

Per vendosjet brenda tubacioneve,duhet te kemi nje montim dhe çmontim komod te kabllove.Ndalohet shtesa e kabllove e percjellesave brenda tubacioneve.Ata duhet te priten ne gjatesine e duhur per çdo rast.

1.1.3 Kanalet dhe aksesorët

Instalime elektrike mund të bëhen në dy mënyra:

- Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
- Mbi suva në kanaleta prej llamarine zinkato te perforuar

Aksesorët e instalimeve nën suva janë:

- Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe të numrit të telave që do të futen në të
- Kutitë shpërndarëse
- Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelësave

Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.

Për kryerjen e instalimeve elektrike të futura nën suva duhet të ndiqet rradha e punës si më poshtë:

- Hapja e kanaleve në mur më dimension të tillë që të vendoset lirshëm tubi fleksibël dhe me thellësi të tillë që të mos dalë mbi nivelin e suvasë përfundimtare.
- Vendosen tubat fleksibël dhe kutitë prej PVC të cilët provizorisht fiksohen me allçi (më vonë mbyllen kanalet me llaç suvatimi)
- Pasi është kryer suvatimi, futen telat ose kabllot, me anë të udhëzuesit të tyre, të cilat duhet të hyjnë lirshëm dhe të lihet në të dy krahët një sasi e mjaftueshme për kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.

Tubot rigjid duhet te jene te tipit termoplastik,vetshuares,me çlirim shume te ulet te halogjeneve,me :

-rezistence150kg/dm ne 20°C

-rezistenca ndaj nxehtesise nga 20 ne +90°C

-Rigjiditeti dielektrikmbi 2000V ne 50Hz per 15'

-vetshuarja ne me pak se 30¨

-padjegshmeria 850°C

-reaksioni ndaj zjarrit categoria I,sipas CSE

-ngjyra gri

Tubat fleksibël duhet të jenë sipas standarteve përkatëse të mëposhtme:

- Përputhja me standartet: CEI 23-32.
- Materiali PVC.
- (Rezistenca) Qëndrueshmëria e izolimit: 100 MΩ
- Shkalla IP:IP40
- Qëndrueshmëria ndaj goditjeve:IK08
- Temperatura e instaluar: -5/60 gradë celsius

Kanalet dhe vendosja e tubave fleksibël PVC duhet të bëhet në distancë 0.4 m më poshtë nga niveli I tavanit në vijë të drejtë horizontale dhe zbritjet për çelësa ose prizat të bëhen vertikale të drejta dhe jo me kënd ose në formë harku.

1.1.4 Kutitë shpërndarëse

Kutitë shpërndarëse në varësi të sistemit që do të përdoret janë për nën suvatim ose mbi suvatim kështu që mënyra e fiksimit të tyre është ose me allçi ose me anë të vidave me upa.

Materiali dhe karakteristikat teknike të tyre janë njëlloj si për tubat fleksibël të përshkruara në pikën 1.1.3.

Përmasat e kutive shpërndarëse variojnë sipas rastit dhe nevojës. Ato janë në formë rrëthore, katrore ose drejtkëndëshe dhe kapakët e tyre mbyllës janë me ngjyra të ndryshme.

E rëndësishme është që lidhja e percjellsave/kabllove brenda në kutitë shpërndarëse të realizohet me anë të klemeve bashkuese ose fundore.

1.1.5 Sistemi i kanalinave

Sistemi i kanalinave ashtu si sistemi nën suva me tuba fleksibël duhet të plotësojë të gjitha kushtet teknike të instalimeve elektrike të përshkruara në pikën 1.1.3.

Sistemi i kanalinave përbëhet nga aksesorët e tij si:

- Kanalet me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të kabllove, që do të instalohen në të, gjatësia 2 m

- Këndorët (shërbejnë për formimin e këndeve në instalime) të cilat janë në varësi të kanalit që po shtrihet

- Devijuesit në formë T

- Kutitë shpërndarëse të dimensioneve të ndryshme

1.1.6 Llampat dhe ndriçuesit

Pozicioni i ndriçuesve duhet të jetë si ai i treguar në projektin elektrik.
Instalimi i ndriçimit do kryhet duke përdorur kabllot FG7(O)R ose percjelles N07V-K, që kalojnë brenda tubit fleksibël PVC, në përgjithësi të fshehura brenda suvasë së ndërtesës ose në kanaleta kur përdoret sistemi i kanalinave.

Kabllot duhet të jenë në seksion minimal 1.5 mm²,per ndricim dhe 2.5 mm², për prizat. Ne të gjitha rastët duhet instaluar nje percjelles tokezimi i i ndare nga nuli i punes.
Ndriçuesit duhen fiksuar me siguri në tavanin ambienteve, të varur ose direkt në sipërfaqen e tavanit sipas llojit të ndriçuesit dhe të rekomandimit të dhëna nga prodhuesi.
Gjatë gjithë pjesëve të tavaneve të varur, ku duhen instaluar ndriçuesit, lidhjet përfundimtare te çdo njerin duhen bërë me anë të një kablli fleksibël tre fijësh, me cilësi të përshtatshme për të duruar nxehtësinë, nëpërmjet një rozete me fisha, lidhur me kutinë ose linjëzimin e kabllove.
Ndriçuesit montohen kur të kenë përfunduar të gjitha punimet e ndërtimit dhe të lyerjes.
Çdo ndriçues duhet të ketë një bllok konektori të fiksuar për të dalluar qartë kabllot hyrëse të fazës, nulit dhe tokës. Ky bllok konektori duhet të ketë përmasa të tilla që brenda tij të përfshihen kabllot me 2.5 mm² në çdo konektor.

1.1.7 Ndriçuesit e emergjencës dhe shenjat e daljes

Paketa e ndriçimit emergjent duhet montuar në ato vende, ku i ka parashikuar Inxhinieri projektues elektrik.
Paketa e emergjencës duhet të përfshijë mbushjen e plotë të baterisë me një ushqyes të aftë për të furnizuar me energji për një orë dhe tubin 18 WATT-ësh.
Kapaku i paketës duhet të ketë ngjyrë jeshile dhe të ketë shenjat përkatëse:

- Një njeri duke vrapuar,
- Shigjetën që tregon drejtimin e largimit,
- Fjalën dalje. të shkruara me ngjyrë të bardhë.

1.1.8 Çelësat e ndriçimit

Vendodhja e çelësave të ndriçimit tregohet sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxinieri elektrik projektues.
Në përgjithësi çelësat e ndriçimit gjatë gjithë ndërtesës duhet të jenë të përshtatshme për montim të rrafshët (nën suvatim).
Çelësat duhet të jenë të parashikuar për kontrollin e rrjetit AC. Duhet të kenë një shkallë minimale prej 10 amper.

1.1.9 Prizat

Një sistem i kompletuar me njësi prizash duhet siguruar sipas projektit dhe skicave të bëra nga inxinieri elektrik projektues.
Të gjitha prizat që do të montohen duhet të jenë të tipit me tokëzim.
Prizat ashtu si edhe çelësat të jenë të tipit që montohen nën suvatim.
Prizat i ndajmë sipas detyrës që do të kryejnë në:

- Priza tensioni njëfazore, ose trefazore
- Priza telefoni dhe sistemi LAN

Gjithë prizat, elektrike duhet të jenë të tipit 16 amper 2P+T

Prizat e telefonisë dhe të sistemit LAN janë të njëjta dhe janë trajtuar më hollësisht në pikën perkatese

1.1.10 Sistemi i tokëzimit

Elektrodat e tokës do jenë me një profil L, të galvanizuar çeliku 50x50x5mm (ose me elektroda togëzimi të zinguara) të futura në një thellësi minimale prej 2 metrash. Numri i elektrodave të tokëzimit varet nga lloji I truallit dhe nga ajo qe Rt (rezistenca e tokëzimit), e cila duhet të jetë më e vogel se 4 Ω. Për këtë pas përfundimit të vendosjes së elektrodave duhet bërë matje me aparat të Rt dhe të mbahet një proçes verbal, I cili duhet t'i paraqitet Supervizorit. Në rast se Rt është më e madhe se 4 Ω, atëherë duhet të shtohet numri I eklektrodave deri sa të arrihet ajo e kërkuara.
Elektrodat vendosën në formë drejtkëndëshi, trekëndëshi apo katrore sipas numrit të tyre por gjithmonë në një largësi 1.50 m nga njëra tjetra. Elektrodat lidhen me njëra tjetrën me anë të një shiriti zingatoje 40mm x 4mm, me anë të saldimit ose me anë të vidave me dado shtrënguese. Pika e lidhjes së elektrodave

duhet të jetë bërë me lidhje përfundimtare kundra ndryshkut. Nga pika e fundit, dilet me shirit zingatoje 40 mm x 4 mm dhe futet në dhomën e transformatorit, në shinën e potencialeve, dhe prej andej në të gjitha pajisjet e dhomës së transformatorit, duke shtrirë një litar bakri tokëzimi me seksion min. 35 mm ².
Nga paneli kryesor i TU shpërndarjes tokëzimi shpërndahet së bashku me kabllin/telat e fazave dhe të nulit, në të gjitha daljet e tensionit dhe duhet të jetë me dimension min. 2.5 mm².
Pjesët metalike të instalimit dhe pjesët e pajisjeve të tjera të lidhura me instalimin duhet të tokëzohen në mënyrë të pavarur nga nuli i shpërndarjes dhe nuli i transformatorit të shpërndarjes. Percjellesi i vazhdimësisë të tokëzimit, duhet të instalohet në të gjithë qarqet dhe të ngjitet në pjesët metalike të ndriçuesve.
Të gjitha pjësët metalike të pajisjeve duhet të lidhen me sisitemin e togëzimit.

1.1.11 Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Sistemi i mbrojtjes atmosferike është shumë i domosdoshëm, për vetë kushtet atmosferike dhe vendodhjen gjeografike në të cilat ndodhet vendi ynë.
Sistemi i mbrojtjes atmosferike është dhe duhet të ngrihet i pavarur, nga ai i sistemit të tokëzimit dhe të plotësojë kushtet e zbatimit sipas KTZ –së së Shqipërisë.
Vlera e rezistencës të këtij sistemi duhet të jetë më e vogël se 10 Ω. Gjatë punës për këtë sistem (pasi të jenë vendosur elektrodat) kryhen matje të R dhe në rast se ajo është më e madhe se 10 Ω, atëherë duhet rritur numri I elektrodave derisa të arrihet kjo vlerë. Matjet duhen përsëritur dy herë. Një herë në tokë me lagështirë dhe një herë me tokë të thatë.
Materialet që do të përdoren për këtë sistem (shiritat, elektrodat që do të futen në tokë, shigjeta, bulonat fiksues etj.) duhet të jenë të gjitha prej zingu ose hekur të galvanizuar.
Shiritat duhet të jenë me përmasa 40 mm x 4 mm ose 30 mm x 3 mm, ose shufër me diametër min. 10 mm.
Elektrodat duhet të jenë me gjatësi 1.5 m, si në rastet kur do të përdoret hekur në formë "L" (50 x 50 x 4 mm) i galvanizuar, ashtu edhe kur do të përdoren elektroda zingu të prodhuara nga fabrika.
Shigjeta duhet të jetë edhe ajo prej zingatoje, psh. një tub zingatoje ¾ ", I cili bëhet me majë dhe ka gjatësi të tillë që të dal min. 0.6 m mbi pikat më të larta të objektit.
Bulonat dhe dadot që do të përdoren për fiksim të shiritit me elektrodat duhet të jenë min. M 12.

2.1. Shpërndarja e fuqisë

2.1.1 Shpërndarja e tensionit të ulët

Rrjeti shpërndarës i tensionit të ulët realizohet sipas projektit elektrik dhe duhet të plotësojë të gjitha kushtet e KTZ në Shqipëri.
Shpërndarja e tensionit të ulët fillon që nga paneli PTU i kabines transformatorit, deri në çdo prizë, çelës dhe ndriçues. Shpërndarja e TU bëhet me anë të percjellsave ose të kabllove, të cilët janë përshkruar në pikën 1.1.2.

2.1.2 Paneli kryesor i tensionit të ulët

Paneli kryesor i tensionit të ulët vendoset në ambjent te pershtatshem ne katin perdhe.
Ai duhet të jetë metalik, i lyer me bojë, që I reziston korozionit, si dhe të jetë i mbyllshëm me çelës.
Përmasat e tij janë në varësi të pajisjeve elektrike që do të montohen, të cilat janë në varësi të ngarkesës së godinës.
Paneli kryesor i TU duhet të përmbajë :

- Matësin e energjisë elektrike 3 fazor (nje fazor)
- Automatin kryesor trefazor 400 V, amperazhi varet nga ngarkesa
- Automatet trefazor për çdo kat (sugjerohet që në çdo kat të shkohet me tre faza në mënyrë që të bëhet një shpërndarje sa më e mirë e ngarkesës dhe siguri më të madhe në furnizim)
- Ampermetra për çdo fazë me tregim në kapakun e tij

• Voltmetër me tre pozicione për të matur çdo fazë me tregim dhe komandim në kapakun e tij
• Sinjalizuesit e fazave me tregim në kapakun e tij
• Klemet e tokëzimit që lidhen me sistemin e tokëzimit

Montimi i tij dhe i përbërësve, duhet të bëhet nga specialisti elektrik sipas projektit.Të gjitha lidhjet e kabllove / telave brenda panelit, duhet të bëhet me anë të klemave bashkuese dhe jo me nastroband. Vetë paneli duke qenë metalik, duhet të lidhet me sistemin e tokëzimit.

2.1.3 Kuadrot shpërndarjes në kate

Këto kuadro, meqënëse do të vendosen në ambiente publike, duhet të jenë të mbyllshëm me çelës për arsye sigurie.

Elementët e domosdoshëm të këtyre paneleve janë:

• Automati kryesor 3 fazor manjetotermik dhe me mbrojtje diferenciale, amperazhi varet nga ngarkesa;

• Sinjalizuesit e fazave (3 copë);

• Automatët manjetotermik njëfazorë të fuqisë (prizave), të cilët në varësi të prizave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;

• Automatët manjetotermik të ndriçimit, të cilët në varësi të ndriçuesave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;

Parashikohet që sistemi i ndriçimit të jetë i ndarë nga ai i fuqisë.

3.1. Kompleti i gjeneratorit

Open Procurement Albania
Public Health Sector

3.1.1 Gjeneratori

Do te perdoren me kerkesen e investittorit dhe montohen jashte objektit prane panelit kryesor te TU.
Gjeneratori duhet të jetë silencioz,me leshim automatic,I një firme të njohur
në fushën e prodhimit të gjeneratorëve, me cilësi të lartë dhe të aprovohet
nga porositesi para montimit.

Montimi dhe vënia në punë e tij për herë të parë, duhet bërë nga një personel i specializuar. Gjeneratori ka gjithashtu nevojë për mirëmbajtje. Për këtë duhet që të zbatohet me përpikmëri grafiku I shërbimeve të dhëna nga firma prodhuese.
Fuqia e gjeneratorit është në varësi të ngarkesës që ai do të mbajë dhe eshte llogaritur nga inxhinieri projektues elektrik.
Veçoritë teknike të mëposhtme për gjeneratorë duhet të merren në konsideratë:
Gjeneratorë më naftë"Stand by" 380V, 3fazor, 50Hz,
Me një depozitë lëndë djegëse për të siguruar punë të vazhdueshme jo më pak se 48 orë rezistent ndaj kushteve të ambientit pajisur me sistem shkarkimi(tymi) dhe antizhurmues.

3.1.2 Kuadri i kalimit automatik te ngarkeses

Kuadri i kalimit automatik në punë të gjeneratorit është një kuadër që zakonisht prodhohet nga e njëjta firmë që ka prodhuar gjeneratorin dhe montohet në afërsi të tij në të njëjtën dhomë.
Detyrat e tij janë që të bëjë kalimin automatik në punë të gjeneratorit në rast se ndërpritet furnizimi me energji nga rrjeti dhe anasjelltas, brenda një kohe të shkurtër nga 10 – 60 sekonda.

Çelësi i transferimit automatik, përfshin 380v 3ph,50 Hz,250A me një sinjal për ndezjen e gjeneratorit, ku voltazhi i linjës është nën limitet-25% deri 15% dhe frekuenca nën diapazonin 47-53 Hz.

4.1. Sistemi I sinjalizimit të zjarrit

4.1.1 Pajisjet e kontrollit

Kontraktori duhet të mbulojë, instalimin, testin, lidhjen dhe garanton një cilësi të lartë të veprimit të pajisjes sinjalizuese të zjarrit dhe sistemit të alarmit duke përfshirë dhe autoparlantet, ndriçuesit, pajisjet e alarmit, kontaktet e thyerjes së xhamit, panelët e alarmit të zjarrit, karikuesin e baterisë, dhe releve të shoqëruar, do sigurohen dhe lidhen në përputhje me specifikimet, sipas pozicioneve të treguara në vizatime. Instalimi do të kryhet me JY- (st) – Y 2x1 mm2 kabëll për shuesit e zjarrit dhe NYMHY 2x1 mm, për altoparlant(ose kablli I shenuar ne projekt).

5.1. Sistemi i telefonisë dhe i te dhenave

Për çdo dalje telefoni treguar në vizatime, kontraktori duhet të sigurojë një prizë tip lidhjeje telefonike RJ11. Per çdo dalje komunikimi te dhenash LAN-prize RJ45

Përpara instalimit, të sistemit kontraktori duhet të konsultohet me autoritetet përkatëse për kërkesat e tyre dhe të pranohen nga projektuesi.

5.1.1Kabllot

Rrjeti horizontal i rekomanduar për instalim duhet të jetë FTP (UTP) 24 AWG, kategoria e 6 për çdo prize RJ45.

Kontraktori duhet të lërë një pjesë të konsiderueshme kablli në dalje për të kryer sa më lehtë montimet (të paktën një metër në anën e postit të punës dhe 3 metra në vendin e IT deri në kompletimin e instalimit të kabllove.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

5.1.2 Prizat

Prizat e rrjetit të telefonise dhe LAN vendosen në të njëjtën lartësi me prizat e tensionit dhe rekomandohen në lartësi 0.5 m. jane të tipit modular,nen suva.

F. KLIMATIZIMI

1.3 Specifikime te Pergjitheshme Te Sistemit HVAC

1.3.1 Sistemi i kondicionimit multisplit



Per kondicionimin e ambjenteve te qwndrave shendetsore apo ambulancave (kati 0-2) është zgjedhur sistemi multisplit inverter.

Sistemi multisplit eshte zgjidhja ideale per keto ambjente duke qene se ofrojne komoditet dhe fleksibilitet per zonen ku instalohen. Keto sisteme pervec inovacionit ne teknologjine qe perdorin, kane eficence te larte te perdorimit te energjise elektrike dhe nivel shume te ulet te zhurmave gjate kohes se perdorimit. Teknologjia inverter mundeson stabilizimin e temperatures duke rregulluar punen e kompresorit sipas ngarkeses termike duke eleminuar shperdorimin e energjise. Instalimi I sistemit multisplit eshte fleksibel, me ndikim minimal ne mjedis dhe me kosto me te ulet krahasuar me sistemet e tjera te kondicionimit.

Procurement Albania
Public Health Secto

1.4 Pajisjet Qendrore Te Sistemit HVAC

1.4.1 Njesie qendrore te kondicionimit per katet(0-2)

Njesia e jashteme mundeson lidhjen nga dy deri ne pese njesi te brendeshme. Teknologjia DC inverter siguron eficence te larte dhe kontroll te personalizuar te cdo njesie te brendeshme.

Njesia per lidhje me 5 njesi te brendeshme ka karakteristike teknike si me poshte:

Dimensionet	Njesia		Lartesi	mm	734	734	734
			Gjeresi	mm	958	958	958
			Gjatesi	mm	340	340	340
Pesha	Njesi			kg	57	57	62
Ventilatori	Fazat	Ftohje	Super I ulet	cfm	847	847	851
			Super I ulet	m³/min	24	24	24.1
		Ngrohje	Super I ulet	cfm	847	847	851
			Super I ulet	m³/min	24	24	24.1

Motorri I ventilatorit	Shpejtesia	Ftohje	Super I ulet	rpm	420	420	
		Ngrohje	Super I ulet	rpm	420	420	
Kompresori	Tipi				Kompresor "swing" Ihermetik	Kompresor "swing" hermetik	Kompresor "swing" hermetik
Gama e punes	Ftohje	Ambienti	Min.	°CDB	-10	-10	-10
			Max.	°CDB	46	46	46
	Ngrohje	Ambienti	Min.	°CWB	-15	-15	-15
			Max.	°CWB	18	18	18
	Ftohje			dBA	59	59	61
	Ngrohje			dBA	59	59	61
Niveli I zhurmes	Ftohje		Nom.	dBA	46	46	48
	Ngrohje		Nom.	dBA	47	47	48
Ftohesi	Tipi				R-32	R-32	R-32
	Ngarkesa			kg	1.80	1.80	2.00
Tubacionet	Shtese gazi			kg/m	0.02 (per gjatesi tubacionesh mbi 30m)	0.02 (per gjatesi tubacionesh mbi 30m)	0.02 (per gjatesi tubacionesh mbi 30m)
	Diferenca ne nivel	IU - OU	Max.	m	15	15	15
		IU - IU	Max.	m	7.5	7.5	7.5
Te dhenat elektrike	Faza				1~	1~	1~
	Frekuenca			Hz	50	50	50
	Voltazhi			V	220-240	220-240	220-240

Public Health Sector

<u>1.5 Terminalet e shperndarjes se sistemit HVAC</u>

1.5.1 Njesi e brendeshme Tokesor

Njesite e brendeshme per apartamentet ne shumicen e rasteve jane zgjedhur te tipit Konsol-Tokesore. Kjo per efektin qe krijon kjo njesi nje shperndarjen e ajrit te kondicionuar duke siguruar komfort maksimal.

Specifikimet teknike per njesite e perdorura ne projekt jane si me poshte:

Dimensionet	Njesia		Lartesi	mm	600	600	600
			Gjatesi	mm	700	700	700
			Gjeresi	mm	210	210	210
Ventilatori		Ftohje	Larte	m³/min	18.2	8.5	10.7
			Ulet	m³/min	14.8	4.9	7.8
			Silencioz	m³/min	14.1	4.5	6.6
		Ngrohje	Larte	m³/min	18.8	9.4	11.8
			Ulet	m³/min	15.0	5.2	8.5
			Silencioz	m³/min	14.4	4.7	7.1
			Nom.	m³/min	18.2	8.5	10.7
		Ngrohje	Nom.	m³/min	16.9	7.3	10.1
Niveli I forces zanore	Ftohje			dBA	62	52	60

	Ngrohje		dBA	62	52	60
Niveli I presi zanor	Ftohje	Larte	dBA	48	39	44
		Ulet	dBA	36	27	36
		Silencioz	dBA	33	24	32
	Ngrohje	Larte	dBA	48	39	45
		Ulet	dBA	46	27	36
		Silencioz	dBA	33	24	32
		Nom.	dBA	42	33	40
	Ngrohje	Nom.	dBA	42	33	40
Tubacionet	Leng	OD	mm	10	6.35	6.35
	Gaz	OD	mm	16	9.52	12.7
	Kondensat			20	20	20

1.5.2 Njesi e brendeshme Hi Wall

Disa prej ambjenteve kane nje kombinim te njesive tokesore dhe murale ne varesi te hapesires se dedikuar per instalim. Specifikimet teknike per njesite e perdorura ne projekt jane si me poshte:

Dimensionet	Njesi		Lartesi	mm	286	286	286
			Gjeresi	mm	770	770	770
			Gjatesi	mm	225	225	225
Ventilatori	Prurja	Ftohje	Larte	m³/min	9.9	10.4	11.8
			Ulet	m³/min	5.8	6.1	6.3
			Silencioz	m³/min	4.8	4.8	4.9
		Ngrohje	Larte	m³/min	10.9	11.1	12.8
			Ulet	m³/min	6.4	6.7	6.9
			Silencioz	m³/min	5.2	5.2	5.2
			Nom.	m³/min	7.8	8.0	8.2
		Heating	Nom.	m³/min	8.5	8.5	8.5
Niveli fuqi Zhurmes	Ftohje			dBA	55	55	58
	Ngrohje			dBA	55	55	58
Niveli presion zhurme	Ftohje		Larte	dBA	39	40	43
			Ulet	dBA	25	26	27
			Silencioz	dBA	20	20	20
	Ngrohje		Larte	dBA	39	40	43
			Ulet	dBA	28	28	29
			Silencioz	dBA	23	23	26
			Nom.	dBA	33	33	34
	Ngrohje		Nom.	dBA	34	34	35
Tubacionet	Leng		OD	mm	6.35	6.35	6.35
	Gaz		OD	mm	9.50	9.50	9.50
	Kondensat				18	18	18

Open Procurement Albania
Public Health Sector

1.6 Tubacionet e shperndarjes

1.6.1 Tubacionet e shperndarjes per sistemin multisplit

Tubat e bakrit

Tubat e bakrit duhet te jene sipas UNI 6507-69 seria B

Bashkimet

Bashkimet duhet te behen me baker ose me bronz.

Kapja e tubave

Kapja e tubave duhet te behet me fashetat perkatese dhe me profile hekuri ne rastet e tubave te medhenj ku do te krijohen konstruksione te posacme te lyera me boje anti-ndryshk.

Izolimi I tubave

Veshja e tubave dhe pjeseve speciale do te behet pas rezultatit pozitiv te testeve.

Materiali izolues

Izolimi termik do te jete me kushtet e meposhtme:
cope lesh xhami, minimum I densitetit 60 Kg/mc
cope sintetike plisteroli, minimumi densitetit 35 kg/mc
Armafleks me qeliza te mbyllura, minimumi densitetit 40 kg/mc

Open Procurement Albania
Public Health Sector

G. PAJISJET E MKZ

Tub celiku pa tegel

- Gjatësia standarde: 6000 mm (+/- 3%)
- Marka e tubave pa saldim (me filetim): EN 10255 S
  Trajtimi i sipërfaqes :te zinkuar ne te nxehte EN 10240 A1
- Temperatura e punës : -10 ˚C/+110 ˚C
- Prova hidraulike : 50 bar
- Presioni nominal ne temperaturën e ambientit :10 bar

Diametro nominale DN	Diametro esterno De	Diametro esterno	Diametro esterno		Spessore	Massa lineica		
			max	min		tubo nero liscio	tubo zincato	tubo zincato vm
	mm	pollici	mm	mm	mm	kg/mt	kg/mt	kg/mt
10	17,2	3/8	17,5	16,7	2,3	0,85	0,89	0,90
15	21,3	1/2	21,8	21,0	2,6	1,22	1,27	1,29
20	26,9	3/4	27,3	26,5	2,6	1,58	1,65	1,66
25	33,7	1	34,2	33,3	3,2	2,44	2,55	2,57
32	42,4	1 1/4	42,9	42,0	3,2	3,14	3,28	3,31
40	48,3	1 1/2	48,8	47,9	3,2	3,61	3,77	3,81
50	60,3	2	60,8	59,7	3,6	5,10	5,33	5,40
65	76,1	2 1/2	76,6	75,3	3,6	6,51	6,80	6,93
80	88,9	3	89,5	88,0	4,0	8,47	8,85	9,03
100	114,3	4	115,0	113,1	4,5	12,20	12,70	13,00
125	139,7	5	140,8	138,5	5,0	16,60	17,10	17,30
150	165,1	6	166,5	163,9	5,0	19,80	20,40	20,80

1.6.1 Fikësit e zjarrit

Fikësit e zjarrit mund ti ndajme në këto tipe:

- Tipe të fiksuara
  - Hidrante brenda ndërtesës
  - Hidrante jashtë ndërtesës
  - Sisteme me sperkatje (nuk jane aplikuar)
- Tipe mobile
  - Bombula të ndryshme

PROJEKTI MEKANIK
Ing.Andis TIRANA
Nr.Lic.M.0393/2

PROJEKTI MNZ
Ing.Erjona Qatipi
Nr.340 Dt. 17/01/2017

KONTROLLOI
Ing.Ditika QATIPI
Nr.Lic.K.0006/8

EMERTIMI I FLETES
SKEMA ELEKTRIKE,SHENIME TEKNIKE, SHENJA DALLUSE

SHKALLA: 1:100
NR.FLETES
MARS 2019
E-03

VULA

INSTALIMI I NDRIÇIMIT Sh.1:125



INSTALIMI I PRIZAVE Sh.1:125



INSTALIMI TELEFONI,LAN Sh.1:125



INSTALIMI I SINJALIZIMIT TE ZJARRIT Sh.1:125



Public Health Sector
Albania

POROSITESI

MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KONSULENT

BOE :

"TAULANT" shpk

&

"ARKIMADE" shpk

adresa:
Rr."Gjikë Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë

KONTRATA

RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË VITIT 2015, SI DHE PËR QENDRAT SHËNDETËSORE DHE AMBULANCAT QË NUK KANË PROJEKTE, NË KUADËR TË RIKONSTRUKSIONIT TË JO MË PAK SE 100 QENDRAVE SHËNDETËSORE & AMBULANCAVE, PËR VITIN 2019

OBJEKTI

RIKONSTRUKSION I QSH ARBANE

ZONA

ARBANE, BASHKIA TIRANE, QARKU TIRANE

FAZA E PROJEKTIT

PROJEKT ZBATIM

PROJEKTI ARKITEKTONIK

Ark. Iva MEZEZI
Nr.Lic.A.0831/4

Ark. Belina KODRA
Nr.Lic.A.1324/2

PROJEKTI KONSTRUKTIV

Ing.Novrus LEVANAJ
Nr.Lic.K.0152/5

PROJEKTI HIDROSANITAR

Ing.Hekuran RAMA
Nr.Lic.H/T.1092/3

PROJEKTI ELEKTRIK

Ing.Arian FINDO
Nr.Lic.E.0843/2

PROJEKTI MEKANIK

Ing.Andis TIRANA
Nr.Lic.M.0393/2

PROJEKTI MNZ

Ing.Erjona Qatipi
Nr.340 Dt. 17/01/2017

KONTROLLOI

Ing.Ditika QATIPI
Nr.Lic.K.0006/8

EMERTIMI I FLETES

INSTALIMET ELEKTRIKE

SHKALLA: 1:125	NR.FLETES
MARS 2019	E-04

VULA

RELACION TEKNIK

LOT 1: RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË VITIT 2015, SI DHE PËR QENDRAT SHËNDETËSORE DHE AMBULANCAT QË NUK KANË PROJEKTE, NË KUADËR TË RIKONSTRUKSIONIT TË JO MË PAK SE 100 QENDRAVE SHËNDETËSORE & AMBULANCAVE, PËR VITIN 2019

Objekti:

Rikonstruksion QENDRA SHËNDETËSORE Arbane

QARKU TIRANË

Open Procurement Albania
Public Health Sector

POROSITËS:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KONSULENT:

TAULANT shpk
Design & Supervision

ARKIMADE

BOE:

"TAULANT" shpk

&

"ARKIMADE" shpk

MARS 2019

Ana konstruktive

Projekti nuk parashikon nderhyrje ne konstruksion, jane zgjeruar dhe eshte rritur lartesia e dyerve per t'i bere ato te aksesueshme per personat me aftesi te kufizuat dhe per te levizur lirisht me barrele. Per objektet qe kane cedime te themeleve eshte nderhyre duke i perforcuar ato me nen themel, ndersa per riparimin e carjeve jane perdorur kapeset beton arme.
Nen theemelet realizohen me betonim, duke filluar me germimin e gjatesise me 1m ; germohet, betonohet kjo pjese mandej lihet pa u prekur nje gjatesi po 1 m dhe fillon procesi nga e para per 1m pasues. Fillimi eshte 1.5 m larg cedimit dhe mbarimi eshte po 1.5 m ne anen tjeter te cedimit. Kur perfundon riforcimi nje ane me alternim procesi vazhdon aty ku u fillua. Keshtu vazhdon deri ne perfundim te zones qe do te perforcohet. Kur te perfundoje cikli kalohet ne perforcimin e hapesires se pare te perforcuar. Per mureve me plasaritje mbi 2 - 4 cm dhe shmangie nga vertikaliteti deri ne 25 mm do te perdoren kapset beton arme. Ato do te jene me gjeresise e murit, me lartesi 20 cm dhe gjatesi 60-70 cm.

1. Catite dhe tarracat

Ashtu sic rekomendohet ne detyren e projektimit:

a.Catite ekzistuese te mbuluara me tjegulla, por qe kane deformime te vogla , me pjese tjegullash te thyera, parashikohet vetem ulja e mbuleses, heqja e listelave, riparimet eventuale ne strukturen e catise kryesisht nivelime, vendosja e listelave te reja, vendosje e nje shtrese hidroizolimi dhe tjegullave ekzistuese ne masen 70 %. Pra do perdoren 70 % e tjegullave te catise ekzistuese. Streha e catise realizohet me karton xhes cimentato i mberthyer ne konstruksion metalik.

b. Catite ekzistuese te mbuluara me tjegulla, qe kane deformime te medha do te rindertohen plotesisht, qe nga konstruksioni, shtresat izoluese dhe tjegullat.

Tavanet ne te dyja rastet do te ndertohen me karton xhes.

c. Objektet qe aktualisht jane me solete, dhe qe kane probleme lageshtire, jane rikonstruktuar komplet. Hiqen te gjitha shtresat ekzistuese te izolimit dhe vendosen shtresat e reja sipas detajeve te projektit duke siguruar hidroizolimin dhe termoizolimin e plote te tarracave.

3. Suvatimet

a. Suvatimet e brendshme, parashikohet te prishen dhe te ribehen, per shkak te kanaleve per instalimet elektrike, te telefonise, te internetit,te instalimeve te ujit te ftohte e te ngrohte ,te ngrohjes me kondicionere, te demtimet eventuale dhe lageshtite.

b. Suvatimet e jashtme nuk i kemi prekim per faktin se ato do vishen me polisterol jeshil e me rrjete e suvatohen rishtas. Eshte parashikuar dhe veshje me grafiato.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

c. Wc-te deri ne lartesine 2m vishen, kemi parashikuar hidroizolim me dy duar mapej dhe veshje me pllaka majolike deri ne lartesine 2 m.

d. Xokoli eshte parashikuar te prishet suvatim ekzistues, te hidroizolohet me nje shtrese llaci me baze cimento pergatitur nga dy komponente A+B, te suvatohet dhe me pas te suvatohet me granil.

4. Shtresat

Shtresat ekzistuese, parashikohet te shqepen, ne masen 100% duke mberitur te shtresa ekzistuese e betonit, realizohet hidroizolimi me dy duar bitum te lengshem, nivelimi dhe me pas, shtrohen pllakat e reja.

Plintusat do të jenë të tipit si pllaka me h=8 deri 10 cm

Shkallet e jashtme ekzistuese, per shumicen e rasteve nuk prishen pasi shtohen per shkak te rampes se personave me aftesi te kufizuar. Shkallet e reja vishen me mermer dhe plotesohen me kangjell me tubo alumin me lartesi 0.9m.

5. Lyerjet

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Eshte parashikuar qe muret e brendshëm dhe tavanet te lyhen me hidromat, kurse pjesa e mureve deri ne derasen mbrojtese të lyhet me boje plastiko me ngjyre te ndryshme nga ajo e murit. Ne te gjithe perimetrin e dhomave eshte vendosur shirit mbrojtes prej druri deri në lartesine e karrikes.

Fasada parashikohet te lyhet me bojera cilesore akreliko dhe me ngjyra sipas fasadave te paraqitura ne projekt.

6. Dyert dhe dritaret

a. Dyert ekzistuese parashikohet te hiqen 100% pasi jane te demtuara. Hapesirat e dyerve do te zgjerohen per t'u bere te aksesueshme nga personat me aftesi te kufizuara. Dyert e dhomave parashikohen druri tamburato te rimesuara dhe te prodhimit industrial, kurse ato ne Wc duralumin dhe e dera e jashteme e blinduar.

Per kushte sigurie, per deren e jashtme, kur nuk jane te bilduara, eshte parashikur nje porte metalike me kase profili dhe strukture kangjell.

b.Dritaret parashikohen duralumin me dopio xham, dhe kangjella metalike. Per kushte sigurie, per dyert e jashtme kur nuk jane te blinduara eshte parashikur nje porte metalike me kase profili dhe strukture kangjell.

7**. Sistemimet e jashtme**

Per cdo rast, kur na lejon siperfaqe e sheshit te ndertimit ne pronesite institucionit, kemi hartuar nje plan sistemimi ku perfshihen:

a.Trotuar rreth e rreth nderteses, me gjeresi sipas mundesise deri ne 90 cm i veshur me pllaka betoni te presuara me trashesi 2 cm.Trotuari kufizohet me bordure betoni 12x25x100 cm te prodhimit industrial.

b. Kunete betoni te hapur me gjeresi 30 cm dhe te mbuluar me zgarre hekuri, ajo vjen qark nderteses.

c. Rruge lidhese dhe shesh te lire kur e lejojne kushtet te shtruar me pllaka betoni te presuara 2 cm per rastet kur nuk hyn ambulanca dhe me trashesi 5 cm kur hyn ajo, Ne kete rast ne fund te sheshit nga ndertesa kemi parashikuar sinjalistike vertikale me tabele metalike dhe horizontale me vizatim me boje, per personat me aftasi te kufizuar.

c.Shesh te gjelberuar te plotesuar me ndonje peme e bime kacavjerese.

d. **Për Personat me Aftësi të Kufizuar (P.A.K),ne cdo ndertese, kur e lejeon siperfaqe e sheshit dhe lartesia e xokolit , eshte parashikuar nje pandus nga niveli i** tokës sistemuar deri në kuoten ±0.00 te nderteses me pjerrësi max. deri 6%. Siperfaqja e pandusit mbi te cilin do te levizin personat me aftesi te kufizuar eshte parashikuar e ashper. Ne te dy anet parashikohet parapet me tubo alumini per tu kapur e terhequr sipas nevojes.

Per rastin kur sheshi ne dipozicion, nuk e mundeson ndertimin e pandusit brenda tij, kemi parashikuar jashte nje pjacolle per ambulancen te plotesuar me sinjalistiken per personat me aftesi te kufizuar.

e.Per rrethimet e jashtme; kur ekzistojne kemi parashikuar riparime e plotesime dhe lyerje duke e sjelle ne parametra bashkekohore, ne rastet kur ai mungon dhe kushtet e lejojne kemi parashikuar rrethim te ri duke vleresuar koston per 1 ml, me analize. Per rastet kur objektet jane ne terene te pjerett dhe jane mesyre nga prurjet e ngurta nga larte, kemi parashikuar qe te qe struktura e murit mbajtes te plotesoje dhe kerkesen per pritjen e dherave nga larte, nderkohe eshte parashikuar largimi i prurjeve.

8. Instalimet Hidrosanitare dhe ngrohjes.

Parashikohet qe ne mjediset e punes te kete uje te ngrohte dhe te ftohte, i siguruar nepermjet instalimit te nje lavamani me bojler elektrik 12 litersh. Rrjeti i furnizimit me uje ekzistues parashikohet te cmontohet 100%. Te njejtin qendrim kemi mbajtur dhe per shkarkimet e brendshme; jane parashikuar te ndertohen te reja ne pershtatje me shperndarjen e lavamaneve ne mjediset e punes. Ne plotesim te kerkeses se Drejtorise se shendetit publik, kemi parashikuar dhe furnizimin me uje edhe ne ratet kur ai mungon ne rrjet. Kemi parashikuar depozita 500 dhe 1000 litershe ne varesi te mjediseve. Depozitat do te jene plastike dhe do vendosen nen cati. Tubi mbrojtes ne cdo rast do te perfundoje ne ulluket e catise .

Open Albania
Public Health Sector

Ne shumicen e qendrave dhe ambulancave nuk ka uje te rrjedhshem per pasoje nuk ka dhe shkarkime, kjo per faktin se dhe fshati nuk ka te tilla; e megjithate qendrat shendetesore apo ambulancat kane instalime te brendshme deri dhe gropa septike por qe nuk funksionojne. Per rastet kur ka kanalizim te jashtem kemi parashikuar punime per rregullimin dhe plotesimin e pusetave dhe gropave septike ekzistuese; kur nuk ka te tilla i kemi parashikuar keto si dhe lidhjen midis tyre me tub shkarkimi PCV me diameter 140 mm.
Shume fshatra aktualisht nuk kane furnizim me uje te pijshem pasi ende nuk jane ndertuar ujesjellesa, gjithashtu nuk kane as kanalizime; e megjitheate qendrat shendetesore apo ambulancat kane instalime te brendshme deri dhe gropa septike por qe nuk funksionojne.

9. Instalime elektrike, telefonike, kompjuterike, mbrojtjes kunder zjarrit dhe i ngrohjes.

Rrjeti elektrik ekzistues nuk shfrytezohet, hiqet ne masen 100 %,. Ndertohen sipas standarteve te kohes rrjetet elektrik, kompjuterik, telefonik dhe te sinjalizimit te rrezikut te zjarrit, parashikohet dhe ndricim emergjence. Rrjetet e ndricimit, te prizave, te bojlereve dhe te kondicionereve jane te ndare nga njeri tjetri. Energjia stakohet komplet ne kuadrin elektrik ne hyrjen e objektit. Rrjti kompjuterik, i telefonise dhe i sinjalizimit te rreziku te zjarrit shkojne ne cdo dhome.

10. Preventivi

Cmimet në preventiv jane vendosur , sipas manualit të vitit 2015. Per zërat e punimeve qe nuk përfshihen në manual, kemi hartuar **analiza (An) të vecanta cmimesh**, qe jane pjese e dokumentacionit t**ë projektit.**

Struktura e preventivit eshte ndertuar ne menyre te tille qe investitori apo enti prokurues , mund te nderhyjne ne objekt dhe te rikonstruktojne nje apo disa elemente, ne pershtatje me mundesite finaciare qe ka. Elementet jane grupuar ne menyre te tille qe, rikonstruksioni i nje elementi apo disa te tilleve eshte perfundimtare, Realizimi rikonstruksionit te elementeve te tjere nuk cenojne rikonstruksionet e meparshme por i plotesojne ato.

Per punimet qe prishen dhe ribehen, kemi hartuar analizen e cmimit qe perfshin te dy operacionet. Kjo lehteson procesin e matjeve dhe eliminom abuzivitet gjate procesit te zbatimit pasi eliminon proces verbalet e punimeve me shume e me pak.

Per : BOE "TAULANT" SHPK

&

"HMK-CONSULTING" SHPK

_____

Ing. Ditika Qatipi

RIKONSTRUKSIONII I AMBULANCES BATHORE
QARKU TIRANE BASHKIA TIRANE

PROJEKTI ELEKTRIK

TABELA E FLETEVE
E-01 TABELA E FLETEVE
E-02 PLANI I VENDIT TË PËRGJITHSHËM
E-03 SKEMA E FUQISË DHE E KONTROLLIT
E-04 DETAJE TIPIKE

POROSITESI

MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KONSULENT

BOE :

"TAULANT" shpk

&

"ARKIMADE" shpk

adresa:
Rr."Gjikë Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë

KONTRATA

RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË VITIT 2015, SI DHE PËR QENDRAT SHËNDETËSORE DHE AMBULANCAT QË NUK KANË PROJEKTE, NË KUADËR TË RIKONSTRUKSIONIT TË JO MË PAK SE 100 QENDRAVE SHËNDETËSORE & AMBULANCAVE, PËR VITIN 2019

OBJEKTI

RIKONSTRUKSION I QSH BATHORE

ZONA

BATHORE, BASHKIA TIRANE, NJESIA ADMINISTRATIVE BATHORE

FAZA E PROJEKTIT

PROJEKT ZBATIM

PROJEKTI ARKITEKTONIK

Ark. Iva MEZEZI
Nr.Lic.A.0831/4

Ark. Belina KODRA
Nr.Lic.A.1324/2

PROJEKTI KONSTRUKTIV

Ing.Novrus LEVANAJ
Nr.Lic.K.0152/5

PROJEKTI HIDROSANITAR

Ing.Hekuran RAMA
Nr.Lic.H/T.1092/3

PROJEKTI ELEKTRIK

Ing.Arian FINDO
Nr.Lic.E.0843/2

PROJEKTI MEKANIK

Ing.Andis TIRANA
Nr.Lic.M.0393/2

PROJEKTI MNZ

Ing.Erjona Qatipi
Nr.340 Dt. 17/01/2017

KONTROLLOI

Ing.Ditika QATIPI
Nr.Lic.K.0006/8

EMERTIMI I FLETES

TABELA E FLETEVE

SHKALLA: 1:100	NR.FLETES
MARS 2019	E-01

VULA



01	NUMURI I LINJES	L-1	L-2	L-3	L-4	L-5	L-6	L-7	L-8	L-9	L-10	L-11
02	RRYMA E AUTOMATIT(A)	10	10	16	16	16	16	16	16	16	16	16
03	NUMURI I POLEVE	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
04	AFTESIA ÇKYÇESE (kA)	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6
05	MARKA E PERCJELLESIT	N07V-K				N07V-K			N07V-K			
06	SEKSIONI (mm²)	3x1.5	3x1.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5	3x2.5
07	MENYRA E VENDOSJES	Ø20	Ø20	Ø25	Ø25	Ø25	Ø25	Ø25	Ø25	Ø25	Ø25	Ø25
08	GJATESIA E LINJES (ML)											
09	FUQIA (kW)	0.5	0.08	1.5	1.5	2	2	2	0.9	0.9	0.9	0.9
10	FAZIMI	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T	A0T
12	DESTINACIONI	Ndriçim	Emergjence	priza pune mjeket	priza pune rec.inf.	liliput	liliput	liliput	split	split	split	split
		AMBULANCA BATHORE										

Shenime

Furnizimi i kuadrit te klinikes do te behet nga pika ekzistuese e furnizimit me kabell FG7(O)R 3x6mm² ne tub fleksibel,vetshuares seria e rende Ø40mm.
Parashikohet nje linje prizash pune dhe linje per çdo liliput,bojler dhe kondicioner split.
Linjat e prizave te shtrihen nen dysheme,kutite shperndarese te jene te perbashketa me ato te ndriçimit aty ku koincidojne.kutite te jene kater kendeshe me kapak me vida,brenda murit.Lidhjet ne kutite shperndarese te behen me morseta.
Per mbrojtjen nga renia nen tension,ne hyrje te kuadrit parashikohet nje çeles diferencial 2 polar 32A,30mA.Te gjitha linjat do te jene me tre percjelles qe nga kuadri;percjellesi i tokezimit me ngjyre verdh-jeshil,i nulit blu.
Ndriçimi parashikohet me llampa led,me ndriçues kryesisht te tipit luçete(te varur).
Projekti parashikon instalime telefonie dhe internet.Ne hyrje parashikohet nje kasete telefonie me dy kopje,ne brendesi nje modem ADSL +router,ne se lidhja me internet behet nepermjet linjes telefonike.Ne se hyrja e internetit do te jete e veçante,ka nje tub bosh qe nga kaseta telefonike.
Parashikohet nje sistem sinjalizimi zjarri tip i adresueshem,me nje qark(loop) detektimi. Detektoret lidhen ne seri njeri pas tjetrit ne formen e qarkut te mbyllur qe fillon e mbaron ne kuadrin e sinjalizimit.Pjese e kuadrit duhet te jete dhe nje ushqyes i pavarur.
Sinjalizimi i zjarrit duhet te montohet nga grupe te specializuar,si sistem komplet,duke marre persiper dhe kolaudimin dhe kontrollin periodik te sistemit.

Shenja dalluese

- Celesa ndriçimi,njepolar,10A,250V
- Celesa ndriçimi,deviat,10A,250V
- Celes-buton,me sinjalizim drite,10A,250V
- Prize me tokezim 2P+T,shuko universale,10/16A,250V
- Celes dy polar 20A,250V,me sinjalizim drite
- Kuti derivacioni,brenda murit
- Panel ndriçues 60x60cm,me llampe led 42w,IP40
- Ndriçues mural, ambjent i jashtem,me llampe led 2x10w,IP65
- Ndriçues mural,led 2x10w,IP40
- 2x21w — Ndriçues me llampa led 2x21w,IP40
- 1x21w — Ndriçues me llampa led ,1x21w,IP65
- Ndriçues i varur me llampe led 25w,IP40
- Ndriçues i varur me llampe led 40w,IP40
- Ndriçues i varur me llampe led 60w,IP40
- Ndriçues emergjence,led 2x10w,IP40
- Kuader elektrik
- Linje elektrike,ndriçimi ne tub fleksibel seria e rende nen suva
- Linje elektrike,ndriçimi ne tub fleksibel seria e rende nen dysheme
- Linje elektrike,priza e fuqie ne tub fleksibel seria e rende nen suva
- Linje elektrike,priza e fuqie ne tub fleksibel seria e rende nen dysheme
- Prize telefonie RJ11
- Prize te dhenash RJ45
- KT-2 — Kasete telefonie e hyrjes
- Modem ADSL+router
- Linje telefonie
- Linje interneti
- Kszj. — Kuader i sinjalizimit te zjarrit
- T — Detektor tymi
- Buton sinjalizimi me dore"break and push"
- Sirene alarmi
- Sinjalizues me drite

Open Society Foundations Albania
Public Health Sector

POROSITESI
MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KONSULENT
BOE :
"TAULANT" shpk
&
"ARKIMADE" shpk
adresa:
Rr."Gjikë Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë

KONTRATA
RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË VITIT 2015, SI DHE PËR QENDRAT SHËNDETËSORE DHE AMBULANCAT QË NUK KANË PROJEKTE, NË KUADËR TË RIKONSTRUKSIONIT TË JO MË PAK SE 100 QENDRAVE SHËNDETËSORE & AMBULANCAVE, PËR VITIN 2019

OBJEKTI
RIKONSTRUKSION I QSH BATHORE

ZONA
BATHORE, BASHKIA TIRANE, NJESIA ADMINISTRATIVE BATHORE

FAZA E PROJEKTIT
PROJEKT ZBATIM

PROJEKTI ARKITEKTONIK
Ark. Iva MEZEZI
Nr.Lic.A.0831/4
Ark. Belina KODRA
Nr.Lic.A.1324/2

PROJEKTI KONSTRUKTIV
Ing.Novrus LEVANAJ
Nr.Lic.K.0152/5

PROJEKTI HIDROSANITAR
Ing.Hekuran RAMA
Nr.Lic.H/T.1092/3

PROJEKTI ELEKTRIK
Ing.Arian FINDO
Nr.Lic.E.0843/2

PROJEKTI MEKANIK
Ing.Andis TIRANA
Nr.Lic.M.0393/2

PROJEKTI MNZ
Ing.Erjona Qatipi
Nr.340 Dt. 17/01/2017

KONTROLLOI
Ing.Ditika QATIPI
Nr.Lic.K.0006/8

EMERTIMI I FLETES
SKEMA ELEKTRIKE,SHENIME TEKNIKE, SHENJA DALLUSE

SHKALLA: 1:100
NR.FLETES
E-03
MARS 2019

VULA

INSTALIMI I NDRIÇIMIT Sh.1:100



INSTALIMI I PRIZAVE Sh.1:100



INSTALIMI TELEFONI,LAN Sh.1:100



INSTALIMI I SINJALIZIMIT TE ZJARRIT Sh.1:100



POROSITESI

MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KONSULENT

BOE :

"TAULANT" shpk

&

"ARKIMADE" shpk

adresa: Rr."Gjikë Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë

KONTRATA

RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË VITIT 2015, SI DHE PËR QENDRAT SHËNDETËSORE DHE AMBULANCAT QË NUK KANË PROJEKTE, NË KUADËR TË RIKONSTRUKSIONIT TË JO MË PAK SE 100 QENDRAVE SHËNDETËSORE & AMBULANCAVE, PËR VITIN 2019

OBJEKTI

RIKONSTRUKSION I QSH BATHORE

ZONA

BATHORE, BASHKIA TIRANE, NJESIA ADMINISTRATIVE BATHORE

FAZA E PROJEKTIT

PROJEKT ZBATIM

PROJEKTI ARKITEKTONIK

Ark. Iva MEZEZI
Nr.Lic.A.0831/4

Ark. Belina KODRA
Nr.Lic.A.1324/2

PROJEKTI KONSTRUKTIV

Ing.Novrus LEVANAJ
Nr.Lic.K.0152/5

PROJEKTI HIDROSANITAR

Ing.Hekuran RAMA
Nr.Lic.H/T.1092/3

PROJEKTI ELEKTRIK

Ing.Arian FINDO
Nr.Lic.E.0843/2

PROJEKTI MEKANIK

Ing.Andis TIRANA
Nr.Lic.M.0393/2

PROJEKTI MNZ

Ing.Erjona Qatipi
Nr.340 Dt. 17/01/2017

KONTROLLOI

Ing.Ditika QATIPI
Nr.Lic.K.0006/8

EMERTIMI I FLETES

INSTALIMET ELEKTRIKE

SHKALLA: 1:100	NR.FLETES
MARS 2019	E-04

VULA

SPECIFIKIME TEKNIKE
PER RIKONSTRUKSIONIN E

RISHIKIMI I PROJEKT PREVENTIVAVE EKZISTUESE QË JANË HARTUAR PËR QENDRA SHËNDETËSORE & AMBULANCA, GJATË VITIT 2015, SI DHE PËR QENDRAT SHËNDETËSORE DHE AMBULANCAT QË NUK KANË PROJEKTE, NË KUADËR TË RIKONSTRUKSIONIT TË JO MË PAK SE 100 QENDRAVE SHËNDETËSORE & AMBULANCAVE, PËR VITIN 2019

Albania
Public Health Center

PARAQITJE

Zerat e rradhitur ne kete specifikim, perkojne me zerat e preventivuar, mbeshtetur ne projektin e hartuar dhe ne "Manualet teknike te cmimeve te ndertimit dhe analizat teknike te tyre" te miratuar me Vendim te Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.7.2015.
Standartet e cilesise se materialeve te perdorura jane, ato te shtetit Shqiptar per materialet prodhim vendi dhe ato te vendeve te Bashkimit Europian per materialet e importit. Ne keto raste Administratori i kontratres vec certifikates se origjines mund te kerkoje dhe certifikatat e cilesise dhe te dhenat per performancen teknike te artikujve qe do te furnizohen.

Standartet e perdorura ne kete specifikim teknik, nuk jane mbeshtetur vetem ne vizatimet e projektit apo te kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit por edhe ne manualet ligjore dhe ne libra te tjere.

Subjekti i perfshire ne hartimin ketij rikonstruksioni, ne rast problemi, mund te beje sugjerime, permiresime dhe plotesime te ketyre specifikimeve, nese kerkohet nga ndryshime te mundshme te kategorive te punimeve ose mungesa e detajeve dhe e materialeve.

TE PERGJITHSHME

-Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates dhe i sherbejne kontraktorit per fazen e pergatitjes se ofertes dhe supervizorit gjate fazes se zbatimit. Kontraktori dhe supervizioni duhet te kene parasysh qe:

-Zevendesimi i materialeve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behet vetem me aprovimin e Supervizorit nese materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara ose nese materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates, per shkak te kushteve jashte kontrollit te Kontraktorit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument- deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materialeve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

-Kontraktori do te verifikoje te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Moszbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Kontraktorin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Kontraktori do te marre persiper te gjithe pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga punedhenesi nese gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

-Kontraktorit nuk do t'i behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuara per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe pajisjet, ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjeter, lehtesi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

-Kontraktori te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve . Zhvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me cdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se Kontraktori te hynte ne Shesh.

-Kontraktori ujin qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Kontraktori do te shtrije rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te pagohen nga Kontraktori. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Kontraktori duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

-Kontraktori do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me KESH – in , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura , ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

Kontraktori, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te punedhenesit, dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine.

Kontraktori do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij nese nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive. Kontraktori do te furnizoje dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

-Kontraktori do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.
Perpara cdo aktiviteti ndertimor, Kontraktori do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jasht akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Kontraktori do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Supervizorit.

Kontraktori duhet te beje forografi me ngjyra sipas udhezimeve te Supervizorit ne vendet e punes per te demostruar kushtet e sheshit perpara fillimit, progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Kontraktorit.

-Kontraktori duhet te kete vecaneristh kujdes ne:

a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone gjate periudhes se ndertimit.

b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te kordinohet puna.

E gjithe puna do te behet ne nje menyre te tille qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithe pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjeter.

Ne pergatitjen e programit te tij te punes Kontraktori gjate gjithe kohes do te beje llogari te plote dhe do te kooperoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun. Nga Punedhenesi rekomandohet qe punetoret e pakualifikuar te merren nga zona.

-Kontraktori do te marre masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikueshme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te vendose dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet.
Kontraktori duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

Open Albania
Public Health Sector

-Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithe veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Supervizori, mund te çoje ne nderprerjen e kontrates.

- Transporti i cdo materiali nga Kontraktori do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jete e siguruar. .Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri.
Te gjitha materialet qe sillen nga Kontraktori, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion per tu kontrolluar nga Supervizori ne çdo kohe.

-Kontraktori duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave dhe zyrave te tij dhe per krijimin e nje zyre per Supervizorin siç eshte specifikuar, te gjitha keto me shpenzimet e tij.

-Kontraktori duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet "sic jane faktikisht zbatuar" ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.
Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Kontraktori do te ruaje te gjithe informacionin e nevojshem per pergatitjen e "Vizatimt sic eshte zbatuar". Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Supervizorin. Keto vizatime do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do ti dorezohen Supervizorit çdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithe konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Kontraktori, gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve " sic eshte zbatuar" do t'i dorezohen Supervizorit per aprovim. Vizatimet "sic eshte zbatuar" ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit. Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve "sic eshte zbatuar" dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Kontraktorit.

Vizatimet duhet te printohen ne format A_0, A_1, A_2, A_3 dhe t'i dorezohen Investitorit ne 3 kopje.

-Kontraktori ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Supervizori.

Open Data Public Health Sector

1. PUNIME PRISHJE

Prishja e çative dhe e taracave perfshin:

Shperberja e mbuleses se çatise me tjegulla te tipit "Marsigliese" ose te tipit "Romana" (Vendi) dhe te armatures perkatese prej druri, duke perfshire Traret e mundshem, dyshemene ose paretet (ndermjetezat) me derrasa, armaturen e madhe (e perbere nga kapriatat, Traret dhe pjeset e armatures), pjeset intersektuese, kanalet e ulluqeve horizontale, ulluqet vertikale dhe kapset perkatese metalike qe rezultojne nga heqja brenda ambientit te kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin dhe venien menjane te tjegullave " Marsegliese" qe do te riperdoren, si dhe çdo detyrim tjeter per t'i dhene fund heqjes.

Shperberja e çatise me tjegulla druri ose llamarine te xinguar, me te njejtat modalitete dhe te armatures perkatese prej druri, duke perfshire traret e mundshem, dyshemene ose paretet (ndermjetezat) me derrasa, armaturen e madhe (e perbere nga kapriatat, traret dhe pjeset e armatures), pjeset intersektuese, kanalet e ulluqeve horizontale, ulluqet vertikal dhe kapeset perkatese metalike, kullezat e oxhakut, duke perfshire skelen, spostimin e materialeve qe rezultojne nga heqja brenda ambientit te kantierit si dhe çdo detyrim tjeter per t'i dhene fund heqjes.

Heqja e tavanit te çfaredo natyre, duke perfshire strukturen mbajtese, suvane dhe impiantin elektrik qe mund te ekzistoje; duke perfshire nder te tjera skelen, spostimin e materialeve qe rezultojne nga heqja brenda ambientit te kantierit, si dhe çdo detyrim tjeter per t'i dhene plotesisht fund heqjes se tavanit.

Prishje e Shtreses horizontale te hidro- izolimit te tarraces me zhvillime vertikale, edhe ne pranine e oxhaqeve, e ndertuar nga tre shtresa te mbivendosura leter katramaje, duke perfshire heqjen e kapakeve te parapetit e te çdo pjese metalike dhe venien menjane e spostimin ne kantier te materialeve qe formohen, si dhe çdo detyrim tjeter per t'i dhene fund plotesisht heqjes se tarraces.

Prishja e suvase ne siperfaqet vertikale deri ne nje lartesi te pakten 30 cm, deri ne dalje ne dukje te muratures, per vendosjen e guaines.

Open Procurement Public Health Sector

Prishje totale ndertese pa rikuperim materialesh perfshin:

-Prishjen e tere nderteses ose nje pjese e saj me cdo lloj mjeti perfshire: tere masat per , puntelimet, skelat e sherbimit, marrjen e masave per aplikimin e te gjithe akteve perkatese te sigurise se mbrojtjes se punetoreve ,pasurise dhe jeten e komunitetit dhe kalimtareve.

- Sinjalet per diten e naten si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve.

-Punimet per rrethimet e perkohshme.

-Riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe restaurimi i tubacioneve publike dhe private.

-Ngarkimin e materialeve qe rezultojne nga prishja, perfshire transportin dhe shkarkimin.

Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje me zgjedhje te materialit per riperdorim perfshin:

Tere kerkesat e pikes 1.1

- Zgjedhjen per ruajtje dhe pastrimin e materialeve te riperdorshme qe rezultojne nga prishja.

-Stivimin e materialeve brenda kantjerit, ngarkimin transportin deri ne magazinat e investitorit dhe shkarkimin.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje e muratures se tulles perfshin:

-Percaktimin dhe perdorurimi e mjetet e pershtatshme, ne varesi te mases qe do prishet.

-Prishjen e suvatimit, veshjes se cfaredo forme, qe jane realizuar ne murin qe prishet, pavaresisht nga trashesia e tyre.

-Skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e nevojshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat pereth.

-Riparimin per demet e shkaktuara ndaj te treteve per nderprerjet dhe ristaurimin normal te tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave te zeza, ujin, dritat etj..), duke perfshire transportin e tere materialeve qe rezultojne nga prishja ne nje vend te autorizuar publik.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Spostimin e materialit brenda ambjentit te kantjerit, si dhe cdo detyrim tjeter per perfundimin e punes ne menyre perfekte ku kerkohet rikuperimi i tullave behet dhe pastrami**,** stivimin e tyre per ruajtje kur do te riperdoren ose te dorezohen ne magazimat e investitorit.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje murature gurit perfshin:

-Percaktimin dhe perdorurimi e mjetet e pershtatshme, ne varesi te mases qe do prishet.

-Prishjen e suvatimit, veshjes se cfaredo forme, qe jane realizuar ne murin qe prishet, pavaresisht nga - trashesia e tyre.

-Skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e nevojshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat pereth.

-Riparimin per demet e shkaktuara ndaj te treteve per nderprerjet dhe restaurimin normal te tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave te zeza, ujin, dritat etj..), duke perfshire transportin e tere materialeve qe rezultojne nga prishja ne nje vend te autorizuar publik. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

-**S**postimin e materialit brenda ambjentit te kantjerit, si dhe cdo detyrim tjeter per perfundimin e punes ne menyre perfekte.

-Ku kerkohet rikuperimi i gureve, behet dhe pastrami**,** stivimin e tyre per ruajtje kur do te riperdoren ose te dorezohen ne magazinat e investitorit.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje e strukturave beton:

-Prishje totale ose e pjesshme e strukturave te betonit vertikale ose horizintale, me shume se 5 cm te trasha, duke përdorur çdo mjet, perfshire puntelimet, marrjen e masave per aplikimin e te gjithe akteve përkatëse te sigurise se mbrojtjes se punetoreve dhe popullsise, sinjalet e dites e te nates si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve, punimet per rrethimet e perkohshme, riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe restaurimi i tubacioneve publike dhe private, duke perfshire ngarkimin e materialeve qe rezulton nga prishja dhe transportin per shkarkim.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Heqje e srtukturave beton arme:

-Heqje e strukturave beton arme ose e pjesëve te tyre, duke përdorur paisje mekanike, perfshire nje prishje te pjesshme per te zvogeluar volumin dhe peshen e blloqeve, perfshire puntelimet, marrjen e masave per aplikimin e te gjithe akteve përkatëse te sigurise se mbrojtjes se punetoreve dhe popullsise, sinjalet e dites e te nates si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve, punimet per rrethimet e perkohshme, riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe restaurimi i tubacioneve publike dhe private, duke perfshire ngarkimin e materialeve qe rezulton nga prishja dhe transportin per shkarkim.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Zgjedhjen, pastrimin dhe stivimin e tjegullave marsejeze dhe lenden drusore, per rastet kur ato i riperdorim, ose duhen te dorezohen ne magazinat e investitorit.

-Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje e tavanit te cfaredo natyre, **perfshire:**

-Strukturen mbajtese, suvane dhe impiantin elektrik- skelen, cdo detyrim tjeter per perfundimin e punes ne menyre perfekte, dhe transportin e te gjithe mbetjeve ne nje vend te autorizuar publik.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje e veshjeve me pllaka majolike perfshin:
-Prishje e veshjeve te mureve te cfaredo lloji dhe prishje e shtreses se llacit qe ndodhet poshte, pastrim, larje, si dhe cdo detyrim tjeter per pergatitjen e siperfaqes per veshje, duke perfshire transportin ne nje vend te autorizouar publik te mbetjeve.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje e suvatimit:
-Goditje e te gjithe siperfaqes se suvatuar dhe gjetje e pjesëve te mufatura dhe të plasaritura nepermjet tingullit, prishjen e ketyre pjesëve deri në daljen e muraturës, ne mure dhe tavane, larje e siperfaqeve te prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine , spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund heqjes së suvasë.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Heqje e arkitrareve perfshin:
-Heqja e arkitrareve prej druri ose betoni ne gjendje te keqe, duke perfshire prishjen e muratures deri ne qiellzen e soletes per te gjithe gjeresine e muratures dhe gjatesine 25 cm pertej hapesires se hapjes (nga te dyja anet), duke perfshire cdo detyrim tjeter per te dhene fund heqjes dhe transportin ne nje vend te autorizouar publik te mbetjeve.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prishje e dyshemeve perfshin:
-Prishje e dyshemeve te cfaredo lloji, duke perfshire prishjen e shtreses se llacit qe ndodhet poshte tyre dhe transportin ne nje vend te autorizouar publik te mbetjeve si dhe spostimin brenda kantjerit te materialit qe rezulton nga prishja.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Heqje e dyerve dhe dritareve perfshin:
-Heqjen e dyerve dhe dritareve te cfaredo permase e lloji, pa i demtuar ato dhe paturat, nxjerjen e tyre jashte nderteses dhe cuarja ne piken e grumbullimit qe do te caktoje investitori.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shqepja e shtresave te dyshemeve me pllaka perfshin:
-Heqjen totale te shtresave me pllaka te te gjitha llojeve dhe permasave apo te pjeseve te demtuar, ashtu sic parashikohet ne preventiv.
-Heqje e shtreses se poshtme te llacit, me te cilin jane fiksuar keto pllaka, pavaresisht nga trashesia dhe nxjerjen e tyre jashte objektit per ne piken e ngarkimit.
-Çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote e te sigurte te shqepjes ne menyre perfekte. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shqepja e shtreses me lluster cimentoje perfshin:
-Prishjen e llustres se cimentos pavaresisht nga trashesia nxjerjen jashte ndertese e materiali pas prishjesdhe transportimi ne piken e caktuar, brenda ambientit te kantierit.
-Çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote dhe shqepjes se shtereses te dyshemese dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.
ne menyre perfekte.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shqepje e trotuareve ekzistues perfshin:

Open Procurement Bulletin Public Health Sector

-Sipas rastit shqepjen e plote apo te pjeseve te demtuara, sic parashikohet ne preventiv, largimin per ne piken e grumbullimit te mbeturinave dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shqepje bazamakeve te shkalleve me materiale te ndryshme perfshin:

-Heqjen e kembe shkeljeve dhe pjeseve vertikale prej granili te derdhur, me gure e blloqe guri, me bazamak granili apo mermeri, ndarjen dhe magazinimin e pjeseve qe mund te riperdoren dhe largimi per ne piken e grumbullimit te mbeturinave pas prishjes dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

-Kontraktori duhet te kete parasysh se demtimi i mureve gjate heqjes se davancaleve ekzistuese eshte ne ngarkim te tij.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Heqje e zgarave metalike perfshin:

-Heqje e zgarave metalike te cfaredo lloji, duke i prere ne vendet ku jane kapur, grumbullimi ne kantier dhe dorezimin e tyre investitorit me proces verbal.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Heqje e sistemit hidraulik perfshin:
Heqjen e gjithe tubacioneve hidraulik ekzistues brenda ose jashte mureve te godines, deri ne tubacionin kryesor te hyrjes.
-Te gjithe tubat dhe pajisjet e hequra duhet te transportohen ne nje vend publik. Riperdorimi nuk lejohet ne asnje rast.
-Kontraktori do te jete pergjegjes per cdo demtim shkaktuar punimeve te ndertimit per mos heqjen e tubave te vjeter dhe mos eleminimin e duhur te demeve.
Garancine per pune te sigurte pet punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Heqje e sistemit elektrik perfshin:
-Heqjen e te gjithe kabllove elektrike dhe tubave plastike, kutive, kuadrove, prizave, celesave elektrike, etj, ekzistuese, brenda ose jashte mureve te godines, deri ne piken publike te furnizimit me energji elektrike.
-Te gjithe kabllot dhe pajisjet e hequra duhet te transportohen ne nje vend publik. Riperdorimi nuk lejohet ne asnje rast.
-Kontraktori do te jete pergjegjes per cdo demtim shkaktuar punimeve te ndertimit per mos heqjen e kabllove, tubave plastike, kutive, kuadrove, prizave, celesave elektrike te vjeter etj, dhe mos eleminimin e duhur te demeve.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

2. PUNIME DHEU

-Puna qe mbulohet nga ky kapitull i specifikimeve konsiton ne furnizimin e gjithe kantierit, puneve, pajisjeve, veglave dhe materialeve qe kerkohen per kryerjen e te gjithe puneve ne lidhje me germimin, hapjen e kanaleve dhe shtresimin e rrugeve, linjave te ujit, linjave te kanalizimit, strukturave te drenazhimit dhe aksesoret, ne perputhje te plote me specifikimet e ketij kapitulli dhe vizatimet e zbatueshme, qe jane subjektit i termave dhe Kushteve te Kontrates perfshihen:
-Te gjitha germimet te cfaredo lloji dheu qe ndeshen do te kryhen ne thellesine dhe gjeresine e percaktuar, sic percaktohet ne vizatimet dhe/ose sic percaktohet me shkrim nga Supervizori. Gjate germimit materiali i pershtatshem per mbushje do te grumbullohet ne nje vend te pershtatshem, ne nje distance te mjaftueshme nga bankinat, per te shmangur mbingarkimin dhe t'i ruaje nga shembja anet e kanalit. Shtresa e siperme e tokes do te grumbullohet vecas per nje riperdorim te mevonshem nese eshte e nevojeshme. I gjithe materiali jo i pershtatshem ose qe nuk kerkohet per veshje do te cohet ne nje vend te aprovuar nga Punedhenesi. Germimi ne rruget do te behet ne menyre te tille qe pasazhi i rruges te mos bllokohet nga materiali i germimit. Nivelimi do te behet ne menyre te tille, nese eshte e nevojeshme, per te ruajtur qe uji siperfaqesor te mos vershoje ne kanale ose ne pjese te tjera te germuara .Cdo sasi uji e mbledhur do te hiqet me ane te pompave ose me metoda te tjera te aprovuara, me koston e vete Kontraktorit.
Kosto e germimeve qe do te behen duke tejkaluar permasat e percaktuara nga projekti ose sic jane kerkuar me shkrim nga Supervizori, do te mbulohet me shpenzimet e vete Kontraktorit. Per me teper, Kontraktori do te jete i detyruar, nese keshtu urdherohet nga Supervizori, te rimbushe germimet ekstra me dhe te ngjeshur dhe gure te thyer ose beton te varfer, si te paraqitet rasti, sipas instruksioneve te Supervizorit, pa perfituar pagesa ekstra ose kompensime per sa me siper.
Eshte parashikuar, qe te gjithe punimet e germimit ne kete kontrate do te jene germim dheu. Termi "dhe" ,sic eshte perdorur ketu do te perfshije te gjitha materialet ,te cilat sipas mendimit te Punedhenesit nuk kerkojne shperthim, heqje ose copetim te materialit, per zhvendosjen nga shtrati i tij origjinal.
-Materialet e dobeta ose pjese te buta, qe ne menyre natyrale ndeshen ne fund te ndonje germimi, do te hiqen me dore dhe do te largohen dhe keto gropa qe krijohen do te mbushen me nje material te pershtatshem ose beton, sic do te udhezohet nga Supervizori. Kjo pune do te matet dhe paguhet me cmimet njesi te aplikueshme. Kerkohen masa dhe garacni per shendetin dhe jeten per punonjesit qe kryejne keto punime, per kalimtaret dhe per komunitetit.

-Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjitha keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per Punedhenesin.

-Te gjitha pemet dhe shkurret e percaktuara nga Punedhenesi qe do te mbeten, do te mbrohen dhe ruhen ne menyren e aprovuar.
Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur, do te largohen sipas udhezimeve te Supervizorit. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themeleve te ndertimeve, qe mund te ndeshen. Kontraktori do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve, qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit .

-Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Supervizorit. Zeri i treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet ,sic eshte largimi i materialit te germuar, etj. do te perfshije cdo lloj kategorie dheu, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Ne rastin kur perdoren tubat shtese dhe me gota, germimi me dore i materialit te shtratit eshte i nevojshem per cdo bashkim. Germimi me krahe eshte gjithashtu i nevojshem ne afersi te intersektimeve te infrastrukturave te tjera, per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me siper , mund te perdoren makinerite.
Nese nuk urdherohet apo lejohet ndryshe nga Supervizori, nuk duhet te hapen me shume se 30 metra kanal perpara perfundimit te shtrirjes se tubacionit ne kete pjese kanali. Gjeresia dhe thellesia e kanaleve te tubacioneve do te jete sic eshte percaktuar ne vizatimet e kontrates ,ose sic do te udhezohet nga Supervizori .
Veshje me pllaka majolike parashikon, veshjen per nje lartesi 2.2 m te mureve, me pllaka majolike te bardha 20x20 cm te cilesise se pare, furnizuar dhe vendosur ne veper mbi siperfaqen e pergatitur me pare, e ngjitur me llac me dozim ne m^2: rere e lare 0,005 m^3, cimento (m-400) 4 kg, stukim me cimento te bardhe, pastrim i plote, skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e veshjes ne menyre perfekte.

Pllakat ne qoshe, nese eshte e nevojshme, do te priten me preres te pershtatshem pllakash, do te shpohen me shpues dhe nuk do te nderpriten aty ku ka pajisje sanitare.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Vendosje plintusa parashikon; te realizohen me materialin e pllakes se shtrimit ose te prodhimit indiustrial si te jete percaktuar ne preventiv, vendosen ne veper mbi siperfaqen e pergatitur me pare, e ngjitur me llac me dozim ne m^2: rere e lare 0,005 m^3, cimento (m-400) 4 kg, stukim me cimento te bardhe, pastrim i plote, skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per mbarimin e veshjes ne menyre perfekte.

Plintuset ne qoshe, nese eshte e nevojshme, do te priten me preres te pershtatshem pllakash, eshte kusht qe plintuset te mos dalin me shume se 5 mm nga siperfaqia e murit ku ato mbeshteten.

Cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

8. DYER E DRITARE

Fv dritare me skelet metalik parashikon.

Furnizim dhe vendosje e dritareve sic pershkruhet ne V.T., permasat e se ciles duhet te percaktohen nga Kontraktori, te perbera nga ele metalike 4x4 cm ose prej hekuri tubolar te perkulur per dritare.

Nje telajo (nuk parashikohet kontrotelajo) do te fiksohet direkt ne mur me fasheta hekuri me llac cimento (jo me tapa me filete). Kanata te hapshme me xhama do te vendosen me mentesha ne skeletin e dritares dhe do te pajisen me brava mbyllese ne tre drejtime dhe doreza.

Xhamat (me trashesi min. 4 mm kur jane transparent, 6 mm kur jane te perforcuar me rrjete teli) do te fiksohen ne skeletin metalik me ane te listelave metalike te vidhosura ne profilet metalike te dritares dhe te strukuar me ngjites. Skeleti dhe telajoja e dritares do te bojatisen pas suvatimit dhe bojatisjes, por perpara vendosjes se xhamave.

Duke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Fv dritare alumini me dopio xham parashikon.

Furnizim dhe vendosje e dritareve sic pershkruhet ne V.T., permasat e se ciles duhet te percaktohen nga Kontraktori, bere me profile alumini me trashesi minimale 4,5 cm, dhe te lyer me pare ne menyre te rregullt, me ngjyre sipas P.P.

Nje kontrotelajo e plote prej tubi metalik te xinguar lehte, do te fiksohet ne mur me fasheta hekuri me llac cimento (jo me tapa me filete). Skeleti i fiksuar i dritares do te vidhoset me telajon pas perfundimit te punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Kanata te hapshme me xhama do te vendosen me mentesha ne skeletin e dritares dhe do te pajisen me brava mbyllese ne tre drejtime dhe doreza.

Xhamat te cilet mund te jene dopio dhe tek (me trashesi min. 4 mm kur jane transparent, 6 mm kur jane te perforcuar me rrjete teli) do te fiksohen ne skeletin e duralumint me ane te listelave te aluminit ne profilet metalike te dritares dhe te shoqeruara me gomina.

Duke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Cdo parti dritaresh duralumini me sasi mbi 100 m2 do te shoqerohet me :

- Fleten e Garancise se prodhimit**,** me te dhenat e prodhimit te dritareve, aksesoreve dhe rrjetave te telit, mostrave e te prodhimit, llogaritjet strukturore per perkuljen dhe raporte per proven e depertimit te ajrit, te ujit dhe te dhenat per montimin dhe mirembajtjen.

-Garancine per cilesise e duraluminit**,** nga uzinat prodhuese, shoqeruar me skicat do te tregojne prerjet vertikale te dritareve, permasat e plota te seksioneve, trashesine dhe dendesine e metalit, paisjet mberthyese, metoden e propozuar per vendosjen e aksesoreve, permasen dhe hapjen e dorezave, detajet e konstruksionit, menyren e vendosjes se xhamave, detajet e funksionimit te paisjeve metalike, detajet e kanatave, metodat dhe materialet per fashaturat, metoda e vendosjes se rrjetave te telit, metoda dhe materiali per vendosjen e pjeseve te brendeshme, kapakeve, parvazeve, trareve, dorezave, detajet e montimit si dhe pjese te tjera te lidhura me to.

-Dritaret e gatshme duhet te vine ne sheshin e ndertimit ne gjendje te pademtuar. Te garantohet ngarkim-shkarkimit dhe ngjitje-zbritjes gjate transportit per ne sheshin e ndertimit. Magazinimi duhet te garantoje mos demtinin gjate ngarkim -shkarkimit dhe vendosjes ne sheshin e pritjes, te jene te garantuara nga agresioni atmosferik, te perjashtohet shtremberimi dhe perkulja. Dritaret e demtuara duhet te riparohen dhe behen si te reja ose ne rast te kundert ato nuk duhet te perdoren por duhet te porositen dritare te reja. Te garantohen nga demtimi **siperfaqja e luciduar gjate transportit magazinimit dhe montimit.**

-Montimi i xhamave do te behet me dy shtresa xhami me trashesi jo me te vogla se 4 mm me hapsire dehidratuese midis tyre dhe te ngjitura hermetikisht. Hapsira midis xhamave do te jete 6 mm.

Gjate montimit te xhamave lejohet nje minimum 3 mm hapsire midis xhamit dhe pjeseve metalike e cila do te sherbeje per elementet ngjites dhe per zberthim. Fiksuesit e xhamave te vendosen dhe zhvendosen lehtesisht. Nuk lejohen fashatura kaucuku sintetik dhe polivinilkloridi.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

Fv dyer te jashtme metalike parashikohet.

Furnizim dhe vendosje e dyerve te jashtme metalike, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga nderrmarja ne kantjer, te perbera nga: nje kontratelajo e fiksuar ne profile metalike te pajisur me fasheta hekuri dhe nje dere nje ose dykanatshe me skelet kryesor me profile standarte metalike dhe panele llamarine me forma dhe dimensione sipas vizatimeve ne projekt. Per porten perfshihet brava e sigurise ne tre drejtime mbylljeje dhe celesa ne tre kopje, piastrat dhe gojezat perkatese, doreza tunxhi dhe te gjithe pjeset e tjera speciale per mbylljen e portes si dhe aksesore te tjere, skelat e sherbimit, punimet e muratures si dhe cdo gje tjeter per ta konsideruar porten te perfunduar dhe funksionuese ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Dyert e jashtme metalike te blinduara do te instalohen ne perputhje me kerkesat e standartit shteteror per montimin e tyre si me poshte:

- nje kase metalike fiksohet ne mur me ane te ganxhave te çelikut ose me ane te betonimit ne mur perpara suvatimit. Kasa metalike duhet te lyhet me boje metalike kundra korrozionit para se te montohet ne objekt. Madhesia e saj eshte ne varesi te trashesise se murit ku do te vendoset. Trashesia e fleteve te çelikut te kases duhet te jete minimalisht 1,5 mm. Gjeresia e pjeseve anesore te kases duhet te jete minimalisht 10 cm kurse gjeresia e pjeses qendrore eshte ne varesi te gjeresise se murit dhe llojit te deres. Fletet e çelikut te kases duhet te kthehen ose te saldohen sipas Kushteve Teknike te Zbatimit

- Kanati i deres se blinduar fiksohet tek kasa pas suvatimit dhe lyerjes. Kanati do te sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelesit gjate instalimit te pjeseve hapese te deres. Ne kete kanat do te vendosen elementet e sigurise si dhe te gjithe aksesoret e nevojshem te saj.

- Kanati I deres ka ne brendesi (ndermjet fleteve te llamarines) shufrat metalike te sigurise me diameter minimal prej 16 mm te cilat vendosen ne distance midis tyre minimalisht 30 cm. Ato duhet te saldohen ne kornizen metalike kanatit te deres se blinduar.

- Ndermjet shufrave vendosen materiale mbrojteset termoizoluese polisteroli me trashesi minimale t = 3 cm. Vendosja e termoizoluesit duhet te behet pas saldimit te shufrave metalike dhe perfundimit te punimeve te prodhimit te kornizes metalike te deres.

- Dera metalike mund te jete veshur me llamarine me trashesi jo me te vogel se 2 mm si dhe mund te vendosen mbi te edhe mbulesa te drunjta me trashesi 2-3 mm (nje nga çdo ane), qe vendosen mbi secilen prej faqeve prej llamarine çeliku, e cila eshte salduar tek shufrat e sigurise me permasa te madhesise se deres.

- Bravat e sigurise se larte se bashku me çelesat sekret montohen ne kornizen e deres me ane te vidave prej çeliku

Dyert e blinduara duhet te jene te kompletuara me mentesha (te pakten 3 per çdo pjese hapese) ne tre pika ankorimi.
Kasa e deres duhet te lyhet me boje te emaluar, transparente perpara fiksimit te deres.
Kur eshte veshur me flete druri mbyllja behet me shirita solide druri te cilat vendosen perreth perimetrit te deres, pune e cila duhet te behet me cilesi te larte sipas te gjitha kerkesave.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e dyerve ne objekt duhet te behen sipas kerkesave teknike.

Fv dyer te brendshme ndertuar me tamburato te rimesuara parashikon:

Furnizim e dyerve te paketuara me pjese nga fabrikat e prodhimit te porositura me permasat sipas percaktimeve ne projekt. Montimin e tyre ne object nga ekip profesionistesh te pajisur me makinerite perkatese qe i pershtaten prodhimit standart me vendin vetem lidhur me lartesine.

Nje kontratelajo ne dru pishe te stazhionuar (me trashesi 3 cm) e imprenjuar, me permasa sipas gjeresise se murit (qe rritet si pasoje e veshjeve te ndryshme te murit), qe do te fiksohet ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (cdo 1 m) dhe me llac cimento.

Nje telajo druri, qe do te vidhoset ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese te pershtatshme sipas tipit te deres, etj.

Kanat dere me dy flete melamine ndermjet te cileve me shirita druri te plote te pajisur me brava sigurie. Dy panelet e melamines do te kene trashesi min. 8 mm, dhe te gjitha bordurat e deres do te mbrohen me shirit druri te plote dhe trashesia e pergjithshme e deres do te jete min. 4,5 cm.

Brava e sigurise dhe celes tip Yale ne tre kopje, doreza tunxhi, dhe piastra e gojeza perkatese, duke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte .

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Fv dyer alumini te brendshme per wc te parashikon:

Furnizim dhe vendosje ne veper dyer te brendshme, permasat e percaktuara ne projekt, te perbera nga:

Nje kontratelajo me tuba metalik xingato, qe do te fiksohet mire ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (cdo 1 m) dhe me llac cimento.

Nje telajo alumini, qe do te vidhoset ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese per instalimin e kanateve te deres.

Kanat dere me profile standarte alumini dhe nga brenda me panel druri te bilaminuar min. 10 mm te trashe.

Brava e zakonshme, doreza tunxhi ose plastike, dhe piastrat e gojezat perkatese dhe shum nga mbrapa.

Buke perfshire punimet e rifinitures ne murature si dhe cdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

9. PUNIME BOJATISJE

Bojatisje me boje hodroplastike per punimet e rehabilitimit, parashikon:

Gerryerje, pastrim dhe heqja e bojatisjeve te vjetra me gelqere te bardhe, boje etj., duke perfshire skelat sherbimit ose skelerine.

Stukimin dhe lemimin e mureve me stuko sintetik, aty ku eshte e nevojshme, per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.

Perpunime me leter e siperfaqeve qe nuk do te lyhen (profilet e dyerve dhe dritareve, plintusa, dysheme, etj.).

Nje dore te vetme praimer te pershtatshem, te aplikuar me furce mbi mure dhe tavane.

Bojatisje me disa duar te mureve dhe tavaneve me boje hidromat, deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Cdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.
Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Bojatisje me boje hidroplastike per punimet e reja parashikon:

-Gerryerje e siperfaqeve ekzistuese te suvatuara per bojatisje.
- Stukimin dhe lemimin e suvase me stuko sintetik, aty ku eshte e nevojshme, per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.
- Perpunimi me leter e siperfaqeve qe nuk do te lyhen (profilet e dyerve dhe dritareve, plintusa, dysheme, etj.).
- Nje dore te vetme praimer te pershtatshem, te aplikuar me furce mbi mure dhe tavane.
-Bojatisje me tre duar te mureve dhe tavaneve me hidromat, te bardhe ose me ngjyre, deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.
-Cdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.
-Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Lyerje me vernik mbi siperfaqe e drurit parshikon:

-Gerryerje, kruajtje dhe pastrim me leter zumpara e bojatisjeve te vjetra, aty ku eshte e nevojshme, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine.
-Kur kerkohet lyerje me boje transparente, heqja e bojatisjeve ekzistuese do te behet e plote.
-Stukimin dhe lemimin e mureve me material mbushes te pershtatshem per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.
-Kur kerkohet lyerje me boje transparente, materiali mbushes duhet te kete ngjyren e drurit.
-Lyerje me disa duar boje vernik (0.2 kg/m^2) mbi siperfaqet e drurit, deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.
-Cdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.
-Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.
Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Open Media Public Health Sector

Lyerje me boje vaji mbi siperfaqe metalike parashikon:

-Gerryerje dhe pastrim me leter zumpara e bojatisjeve te vjetra, aty ku eshte e nevojshme, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine.

-Kerkohet paraprakisht nje dore e vetme praimer ose boje kunder ndryshkut, vajore, me dozim 0.08 kg per m^2.

-Lyerje me nje dore boje antiruxha dhe 2 duar boje vali me ngjyre portokalli (0.2 kg/m^2) deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte. Cdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte. Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit. Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

10. PUNIME TE NDRYSHME

Fv pragje te jashtem me granil me element te gatshem granili, me mermer dhe me dru parashikon ,realizimin e tyre me pedence qe ujrat mund te kullojne, nga ana e jashtme elemeti duhet te jete i paisur me nje kanal qe realizon pikimin e ujit dhe mbron muret nga rrjelljet e tij. Montimin e tyre ne menyre perfekte dhe te nivelura ne fasade. Kontraktori duhet te kete parasysh se cdo punim shtese per te niveluar davancalin eshte ne ngarkim te tij.

Cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

FV bazamak shkalle te brendshme, me element te parapergatitur granili, me mermer apo material te tjera parashikon: vendosjen e elementit qe shkelet, ne menyre te persosur dhe vetem pasi te jene bere shenimet perkatese. Kembe shkeljet jane gjithmon me te trasha se elementi vertikal veshes i shkalles.Shkallet duhet te nivelohen ne perfeksion dhe ne menyre apsolute nuk pranohet qe te kete diference kuote nga shkalla ne shkalle qofte dhe me mm. Rampat mund te jene me lartesi shkalle te ndryshme nga njera tjetra. Elementi vertikal i shkalles duhet detyrimisht te mbeshtet mbi elementin horizontal te saj, te jete apsolutisht vertical. Ato parashikohet qe te fiksohen me allci.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Montim profil dopio T 20 100x200x7 mm per formimin e arkitrareve:

Arkitrau me profil dopio T 20 100x200x7 mm eshte perdorur ne rastin kur nje dritare zmallohet duke perfshire dy apo me shume dritare ekzistuese. Para se te behet prishja e mureve ndermjet dritareve qe do te hiqen, montohet arkitrau I ri I cili ne rastin konkret eshte 6m. Per te mos krijuar problem teknike dhe per te mos rezikuar shendetin dhe jeten e punonjesve qe do te meren me kete process, te kalimtareve inxhinieri I objektit duhet te planizoje punen dhe te percaktoje radhen e punes qe ne rastin konkret eshte parashikuar.

Ndertimi i skeles e nevojshme e qendrueshme nga Brenda dhe nga jashte murit.

Shenohet vendi ku do te pozicionohet arkitrau I ri I dritareve ose me shume bashperforcimi i soletave ekzistuese"SAP" (solete e perzier me tulla me vrima dhe mbushje beton arme) me shtrese beton arme, 8 cm te trashe, zbatuar sipas radhes se meposhtme:

Hapja e kanalit anesore vetem ne nje ane me gjeresi me te vogel se gjysma e trashesise se murit. Nese arkitrau i ri eshte ne nje nivel me arkitraret ekzistues hiqet dhe arkitrau parafabrikat ekzistues.

Montohet profili dopio T duke e pozicionoar drejte dhe ne nivelin e cakruar. Vishet me rrjete teli dhe mbushet me llac granili me raportin 1:2. Mbushja realizohet me disa duar.

Vetem pasi te jete stazhionuar mbushja kalohet ne krahun tjeter duke respektuar te njejten rradhe pune.

Do vleresuar qe ky process do te behet me interval dhe jo ne vijimesi.

Vetem pasi te jemi te bindur se arkitrau i formuar eshte i gastshem mund dhe lejohet te filloje procesi i punes prishjen e mureve ndermjet dritareve.

Gjithcka realizohet sipas udhezimeve te inxhinierit te objektit, duke perfshire, puntelimet, skelen e sherbimit, punimet e mundshme me murature etj., cdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e perforcimit dhe realizimin e tij ne menyre perfekte duke siguruar garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit.

Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato, h=30~50cm , h=80~90cm parashikon:

Pergatitjen dhe montimin e parapetit ne formen dhe lartesine qe kerkon projekti. Kapja e parapetit me bazamentin eshte e shpeshte jo me larg se 1m , duhet te realizohet me upa d=14 mm. Parapetet duhet te jene te mbrojtur me veshje deri ne momentin qe I dorezohet investitorit.
Cdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte, nuk pranohen lekundje, deformime demtime dhe gervishtje te elementeve perberes te parapetit.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

B. PUNIME SISTEMIMI

Germim me çekiç me ekskavator me zinxhir i shtresave te betonit dhe te asfaltit, ne rruget ekzistuese qe do te shtrohen me pllaka betoni parashikon:

Thyerjen e shtresave ekzistuese me aspfalt apo beton, apo te dyja bashke, grumbullimi i materialit te coptuar dhe stukimi ne vend te pershtatshem per tru riperdorur si material mbushes ne rruge apo pas mureve mbajtes.

Ndertimi i rrrugëve te brendshme parashikon:

Zbarnkim dheu për pastrimin e truallit te siperm, i kryer ne çfarëdo menyre, duke perfshire prerjen dhe largimin e pemeve, shkurreve, cungjeve, rrenjeve dhe heqjen e shkembijve ne siperfaqe, sic tregohet ne Planin e Pergjithshem.

Ekzekutim, ne çfarëdo menyre, i gërmimit per realizimin e nje themeli per bordurat e rrugëve dhe per kanalet anesore te kullimit 50x50 cm ne te dy anet e rrugës, duke perfshire realizimin e pjerresive dhe tubacioneve me tuba betoni me diameter 40 cm nen rrugë, per kullimin e ujrave aty ku eshte e nevojshme.

Ngjeshje me kujdes e siperfaqes se truallit perpara vendosjes se shtresës se pare 15 cm me gure lumi dhe të shtresës se dyte perfundimtare 10 cm me te gjithe perbërësit qe duhen per rrugët, te dyja te ngjeshura mire me rul.

Rruga perfundimtare do te profilohet me kujdes per kullimet anesore te ujrave, siç përshkruhet ne projekt.

Vendosje e bordurave parafabrikat ne secilen ane te rrugës, te vendosura mbi nje baze betoni M-150 te derdhur ne shtresa te vibruara mire, me dozim per m3 sic tregohet ne artikullin e mesiperm 4.a.4, duke lene ne çdo 5 m, nje hapesire te hapur prej 20 cm per kullimin e ujrave, duke perfshire te gjitha detyrimet e nevojshme per perfundimin e punes ne menyre perfekte.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

C. SPECIFIKIME/NORMA PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR

- **Njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre:**

Dyert, hapësirat e dyerve të hyrjes së çdo ndërtese dhe të çdo njësie të patundshme duhet të jenë të paktën 80 cm. Hapësira e dyerve të tjera duhet të jetë të paktën 75 cm. Hapësirat para dhe pas derës duhet

Open Albania
Public Health Sector

të jenë në përputhje me minimumin e parashikuar në skemat grafike të dhëna si më poshtë. Lartësia e dorezave duhet të jetë midis 85 dhe 95 cm (e këshillueshme 90 cm) dhe për dritare në lartësinë 90~120 cm. Duhet t'u jepet përparësi zgjidhjeve me një kanat të vetme për dyert që nuk kanë gjerësi më të madhe se 120 cm dhe xhamat të jenë vendosur në një lartësi 40 cm nga plani i ecjes. Elementët për pastrimin e këpucëve duhet të vendosen në nivelin e dyshemesë.

Zgjidhjet e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara: hapësirat përpara dhe pas dyerve

HAPJA NË DREJTIM TË KUNDËRT ME LËVIZJEN – HAPJA NGA E MAJTA



HAPJA NË DREJTIM TË KUNDËRT ME LËVIZJEN – HAPJA NGA E DJATHTA



HAPJA NË DREJTIM ME LËVIZJEN – HAPJA NGA E DJATHTA



HAPJA NË DREJTIM ME LËVIZJEN – HAPJA NGA E MAJTA



Dorezat në dyer dhe dritare.

Vendosja e instalimeve.



Open Procurement Albania
Public Health Sector

Dyshemetë, disnivelet e mundshme të tyre nuk duhet t'i kalojnë 2,5 cm. Aty ku janë parashikuar shtrime të rrugëve kundër rrëshqitjes.

Sipërfaqja relievore

Struktura me lugje; Struktura me thepa



Hapësira e hyrjes.



- **Instalimet elektrike**

Instalimet elektrike duhet të kenë:

- interfon të vendosur në lartësi deri 120 cm nga dyshemeja me indikacione drite;
- ndërprerës i dritës dhe ziles i vendosur në lartësi prej 90 deri 120 cm nga dyshemeja;
- prizat në kuzhinë vendosen mbi sipërfaqen e punës;
- prizat e tjera të vendosura në lartësi prej 90 deri 120 cm nga dyshemeja;
- kuadër elektrik vendosur në lartësi prej 90 deri 120 cm;
- të gjitha pajisjet e instalimeve elektrike të kenë ngjyrë në kontrast me sipërfaqen ku montohen.

Terminalet e impianteve ku hyjnë pajisjet elektrike, kuadrot e përgjithshme, valvulat dhe rubinetet, e bllokimit të përdorimeve të ndryshme, rregullatorët e impianteve të ngrohjes dhe të kondicionimit, zilet e alarmit, citofoni, duhet të vendosen në një lartësi midis 40 dhe 140 cm. Shenjat treguese që përdoren janë si me poshte.

Komunikimi (hapësirat e komunikimit).
Montimi i instalimeve, praku.



- **Platforma levizese**

• 340 kg kapacitet •Maksimumi i distances vertikale of 3,000 mm •Shpejtesia e levizjes perafersisht 0.13 m/s
•900 x 1,400 mm dimensioned standart te kabines
•115 VAC levizje (115 VAC levizje siper dhe 12 VDC bateri poshte)
•Bateria e emergjences ne ulje
•Raportim defekti ne ulje
•sistem levizjeje 2:1me zinxhir hidraulik
•Pompe hidraulike e tipit me ingranazh
•2.5 m gjatesia e udhezuesit te tipit shine
•Udhezues cilinder
•1.5 hp (1.119kW)
•Kontroll elektronik pa rele
•Sistem automatik i karikimit te baterise (115 VAC)
•Kombinim i bllokimit mekanik dhe kontaktit elektrik
•Ndryshim normal limit
•Butona kontrolli ne platforme
•Stacion telefonie
•6,067 mm lartesia e paneleve mbrojtese anesore
•Siperfaqja e dyshemese se kabines jo e rreshqiteshme
•Pluhur veshes elektrostatik ne ngjyre bezhe mbi gjithe siperfaqen e hekurit dhe
•Nuk nevojitet dhome makinerie

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Shërbimet higjienike duhet të garantojnë manovrimin dhe përdorimin e pajisjeve të personave me aftësi të kufizuara motorike, duhet të parashikojnë në lidhje me hapësirat e manovrimit, afrim anësor te WC-ja, bideja, vaska, dushi, lavatriçja dhe afrim ballor te lavamani. Kështu duhen respektuar përmasat minimale të mëposhtme:

- Hapsira e nevojshme e afrimit dhe e lëvizjes anësore e karriges me rrota te WC-ja dhe bideja, nëse është e parashikuar, duhet të jenë minimumi 100 cm, e matur nga boshti i pa isjes sanitare
- Hapsira e nevojshme e afrimit anësor e karriges me rrota te vaska, duhet të jetë minimumi 140 cm përgjatë vaskës me një thellësi minimale 90 cm;

- Hapsira e lirë për lëvizjen me karrocë për PAK duhet të jetë me sipërfaqe rrethore me diametër të paktën 150 cm
- Hapsira e nevojshme e afrimit ballor e karriges me rrota te lavamani, duhet të jetë minimumi 80 cm e matur nga ana e përparme e lavamanit. Për sa i përket karakteristikave të pajisjeve sanitare përveç të tjerash lavamanët duhet ta kenë pjesën e sipërme të vendosur në 80 cm nga dyshemeja dhe të jenë pa kolonë me sifonin mundësisht gjysmë të mbyllur ose të futura në mur;
- WC-të dhe bidetë të jenë të tipit të varura, në mënyrë të veçantë boshti i WC-së ose i bidesë duhet të vendoset në një distancë minimale 40 cm nga muri anësor, pjesa e përparme duhet të jetë më e madhe se 65 cm nga muri mbrapa dhe pjesa e sipërme duhet të jetë 45-50 cm nga dyshemeja. Në rast se aksi i WC-së ose i bidesë është më shumë se 40 cm largë nga muri, duhet parashikuar një hallkë ose parmak për të lejuar lëvizjen në një distancë 40 cm nga aksi i paisjes sanitare. Paisja e lëshimit të ujit në WC të vendoset në lartësinë prej 70 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë;
- Dushi duhet të vendoset poshtë, i paisur me një karrige që ulet dhe ngrihet dhe me telefonin e dushit;
- Varsja e rrobave duhet të vendoset në lartësinë prej 120 cm nga dyshemeja;
- Të gjitha paisjet duhet të kenë kontrast të theksuar në ngjyrë nga dyshemeja dhe muret;
- Instalim i mekanizmit të hapjes së derës nga jashtë në rast dhënie të ndihmës së shpejtë;
- Instalim i sistemit të alarmit brënda banjos për t'u përdorur nga PAK në raste nevoje.

Në banesat e arritshme të banuara, të dhënat në nenin 3 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje, përveç të tjerash, duhen vendosur paisje me hallka dhe parmakë horizontalë dhe/ose vertikalë pranë paisjeve.
Në shërbimet higjenike të vendeve publike është e nevojshme instalimi i parmakëve pranë WC-ve, të vendosur me një lartësi prej 80 cm nga dyshemeja dhe me diametër baras me 3-4 cm; nëse është i fiksuar në mur duhet vendosur 5 cm larg nga vetë ai.
Në rastin e përshtatshmërisë lejohet heqja e bideve dhe zëvendësimi i vaskës me një dush të vendosur poshtë, me qëllim që të përfitohet një hapësirë anësore për afrimin te WC-ja dhe për të përcaktuar hapësirat e mjaftueshme të manovrimit.
Në banesat e ndërtesave rezidenciale, në të cilat është parashikuar kërkesa e mundësisë së shfrytëzimit, shërbimi higjenik do të quhej i arritshëm nëse do të mundësohej të paktën arritja e një WC-je dhe e një lavamani nga ana e personit në karrige me rrota. Me arritje të pajisjeve sanitare kuptohet mundësia për të arritur deri afër saj edhe pa afrimin anësor për WC-në dhe afrimin ballor për lavamanin.
Shenjat për mundësinë e shfrytëzimit të ambjenteve të shërbimit higjenik jepen si me poshte.

Open Albania
Public Health Sector

WC.
Mekanizmi për lëshimin e ujit.
v = 70 cm.
Instalimi i alarmimit.







Rrugët horizontale dhe korridoret duhet të kenë një gjerësi minimale 100 cm, dhe zgjerime të përshtatshme për të lejuar ndryshimin e drejtimit të lëvizjes nga ana e personit në karrige me rrota. Këto zgjerime duhet të realizohen në pjesët fundore të korridoreve dhe gjithashtu të parashikuara për t'u

realizuara çdo 10 m në zhvillim linear. Për pjesët e korridorit ose të sheshpushimeve ku hapen dyert duhen përshtatur zgjidhje teknike në përputhje me mënyrat e hapjes së dyerve dhe të hapësirave të lira të nevojshme për kalimin, si dhe zgjidhjet teknike:

- Hapësira neto e portës e barabartë me 75 ~ 80 cm kur:

  a. Kalimi në hapësirën e portës të vendosur në faqe muri është perpendikulare me kahun e drejtimit të karriges me rrota për:
  a-1. nevojat e lëvizjes mbrapa gjatë hapjes, bazen e sipërfaqes së lirë të nevojshme është 190 cm ndërsa gjerësia nga korridori 100 cm.
  a-2. manovër të thjeshtë, pa lëvizur mbrapa, hapësira anësore që duhet respektuar është 45 cm ndërsa sipërfaqia e lirë e bazës duhet të jetë 135 cm.
  a-3. gjerësi të lirë 100 cm, sipërfaqia e lirë e bazës duhet të jetë 120 cm.

  b. Kalimi në hapësirën e portës të vendosur në një faqe muri është paralel me kahun e drejtimit të karriges me rrota për;
  b-1. gjerësi të korridorit 100 cm, hapësirë e nevojshme përtej portës duhet të jetë 20 cm, hapësira për fillimin e manovrimit përpara portës duhet të jetë 100 cm dhe hapja e portës më shumë se 90°. E njëjta gjë vlen dhe për hyrjen në kah të kundërt.
  b-2. gjerësi të korridorit 100 cm hapësira e nevojshme përtej portës duhet të jetë 110 cm për të lejuar hapjen dhe hapësira e nevojshme përpara portës duhet të jetë aq sa vend zë karroca.. E njëjta gjë për hyrjen në krah të kundërt.
  b-3. gjerësi të korridorit 100 cm hapja e portës është përtej 90°, hapësira e nevojshme përtej portës në korridor është 10 cm, hapësira e nevojshme përtej portës në hapësirën e hyrjes është 20 cm dhe hapësira e nevojshme përpara portës, në korridor të paktën 90 cm, për të garantuar kthimin.

  c. Kalimet në holle dhe nëpërmjet portave vendosur në linjë të drejtë mes tyre dhe në faqe muri perpendikulare me kahun e lëvizjes së karriges me rrota për:
  c-1. Nevoja lëvizjeje mbrapa gjatë hapjes së portës hapsira bazë e nevojshme është 190 cm, hapsira bazë e nevojshme përpara hollit është 120 cm dhe gjerësia e hollit 100 cm. c-2. Manovrime të thjeshta, pa qenë i detyruar të kryesh lëvizje mbrapa hapësirë në anë të portës së dytë është 45 cm, hapsira bazë e nevojshme është 180 cm dhe gjerësia e nevojshme është 135 cm.
  c-3. Nevoja lëvizjeje mbrapa gjatë hapjes së portës gjerësia e hollit është 100 cm dhe hapsira e nevojshme e bazës është 190 cm.
  c-4. Manovrim të thjeshtë pa qenë nevoja për lëvizje mbrapa hapësira bosh në anë të portës së dytë është 45 cm dhe hapsira e nevojshme bazë është 210 cm..
  c-5. Manovrim të thjeshtë pa qenë nevoja të lëvizje mbrapa hapsira e nevojshme bazë është 170 cm dhe hapsira e nevojshme bazë përpara hollit është 135 cm.

  d. Udhëkalimet që ndodhen në holle dhe kalojnë nëpërmjet portave perpendikulare mes tyre janë me:
  d-1. gjerësia të hollëve 100 cm dhe kanë hapësirat e nevojshme përtej portës 20 cm, si dhe hapësirë e nevojshme mes dy portave 110 cm.
  d-2. Gjerësi të hollit 100 cm, hapje të portave në 90° dhe hapsira e bazës së hollit 140 cm.

Zgjidhjet a-1, c-1, c-3 janë të pranueshme vetëm në rast përshtatjeje.

Platformat e pjerrëta (rampat)

Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disniveli deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet:

- pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);
- gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendëshme;
- shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës,
- sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;
- rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;
- dorezë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
- rrethim i rampës i cili gjendet në hapësirat e jashtme, doreza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike ;
- rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;
- përdorim i shenjave të përshtatjes.

Pjerrësia e platformave nuk duhet t'i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi më të larta, në rastet e përshtatshmërisë, të lidhura me zhvillimin linear efektiv të platformës.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Rampa

≥ 120 cm në hapsirat e jashtme
≥ 90 cm në hapsirat e brendëshme





≥ 120
≥ 90



Mbështetësi i dorës (koromano)

Dorezat rrethore



Dhoma, klasa dhe hapësira e punës

Public Health Sector

Dhoma, klasa dhe hapësira e punës duhet të kenë hapësirë komunikimi të lirë për lëvizje me karrocë për PAK, me sipërfaqe minimale rrethore me diametër 150 cm, hapësirë komunikimi për lëvizje rreth mobilieve (orendive) me gjerësi të paktën 120 cm; tavolinë pune e realizuar në formë konsoli ku distanca e sipërfaqies së sipërme nga dyshemeja të jetë 85 cm, ndërsa gjërësia në të paktën 70 cm me thellësi afrimi 50 cm.

Pajisjet e palëvizshme

Në ndërtesat e banuara kutitë për postën nuk duhet të vendosen në një lartësi më shumë se 140 cm.
Në vendet e hapura për publikun, ku kontakti me njerëzit bëhet nëpërmjet tavolinave, duhet parashikuar një hapësirë e përshtatshme e lirë, mundësisht në një ambient të ndarë, që të bëhet një pritje normale, ku përveç të tjerash mund të vendosen një numër vendesh të mjaftueshëm për t'u ulur (preferohen karriget e ndara).
Distanca përpara çdo tavoline duhet të jetë të paktën 150 cm dhe anash të paktën 120 cm me qëllim kalimin me lehtësi mes tavolinave.
Në vendet e hapura për publikun, në të cilat kontakti me njerëzit bëhet nëpërmjet sportelit të banakut të zgjatur ose në mure, duhet mundësuar një pritje e përshtatshme për publikun, me qëllim që të evitohet shfaqja e situatave patologjike të nervozizmit dhe të lodhjes. Sidoqoftë në vende të tilla duhen krijuar hapësira të lira, mundësisht në ambiente të ndara, ku mund të bëhet një pritje normale, në të cilën përveç të tjerash mund të vendosen një numër i caktuar vendesh për t'u ulur (preferohen karriget e ndara).
Për sa u përket flukseve të veçanta të njerëzve, duhet të parashikohen barriera ndarëse udhërrëfyese, të cilat duhet të jenë me një gjatësi të njëjtë me atë të radhës së njerëzve dhe që konsiderohet si mesatarja e flukseve të mëdha dhe me një gjerësi minimale prej 70 cm. Barriera që ndan rrugën e afrimit te sporteli nga ai i daljes duhet të ndërpritet nga një distancë prej 120 cm në përfundim të pengesave të banakut të zgjatur ose të planit të punës së sportelit në mur. Në çdo rast barrierat ndarëse udhërrëfyese nuk duhet të

kenë një gjatësi më të madhe se 400 cm. Barrierat ndarëse udhërrëfyese duhet të jenë të fiksuara fort në dysheme dhe të kenë një lartësi në nivelin e një bordure prej 90 cm.
Të paktën një sportel duhet të ketë planin e përdorimit për personat në karrige me rrota, i vendosur në një lartësi baras me 90 cm nga toka në vendin e rezervuar për publikun.
Në vendet e hapura për publikun ku kontakti me njerëzit bëhet nëpërmjet banakut të zgjatur, të paktën një pjesë e tyre duhet të kenë një plan përdorimi për njerëzit, i vendosur në një lartësi baras me 85cm nga toka.
Pajisjet automatike të çdo lloji për përdorim publik, të vendosura në brendësi ose jashtë njësive të patundëshme të hapura për publikun, duhen që për nga pozicioni, lartësia dhe komandat të mund të përdoren nga personat në karrige me rrota.

Plani orientues për lëvizje në ndërtesa

Plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievore dhe të plotësoj kushtet në vijim:
- të jetë i vendosur horizontalisht deri në 90 cm lartësi dhe vertikalisht deri në 180 cm lartësi nga kuota e dyshemesë.
- të jetë i vendosur pranë hyrjes së ndërtesë;
- të përmbajë informacion në shkrimin Braille;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vij relievore drejtuese në kahje të lëvizjes;
- të tregohet drejtimi për t'a arritur

Shenjat e përshtatjes për PAK-në

Në vijim paraqiten shenjat e përshtatjes. Dimensionet dhe ngjyra e të gjitha shenjave të arritshmërisë, si dhe lloji i materialit nga i cili është punuar përcaktohen në raport me:
- planin në të cilën vendoset shenja;
- forma e hapësirave të jashtme dhe/ose të brendëshme;
- distanca nga e cila PAK duhet të vërejë shenjën.

Public Health Sector

1 shenja e pershtatjes se ar...ave ne karrige me rrota

1.2 shenja e pershtatjes per persona te verber

1.3 shenja e pershtatjes per persona me shikim te dobesuar

1.4 shenja e pershtatjes per persona te shurdhet dhe me degjim te dobesuar

1.5 shenja e pershtatjes per persona me shkop ose paterice

1.6 shenja e pershtatjes per persona qe evizin me sshkop ose qen

1.7 shenja e pershtatjes per persona me karroce femijesh

1.8 shenja e rampes se pershtatur

1.9 shenja e shkalles se pershtatur

1.10 shenja e ashensorit te pershtatur

1.11 shenja e platformes se pershtatur

12 shenja e platformes palosese

1.13 shenja e hpasires hyrese te pershtatur

.14 shenja e WC se pershtatur

1.15 shenja e banojs ose e kabines se dushit e pershtatur

1.16 Shenja e barit ose kafenese se pershtatur

1.17 shenja e hyrjes se pershtatur ne plazh ose pishine

1.18 shenja e telefonit te pershtatur

1.19shenja e pershtatjes se tekstofonit dhe bankomatit

1.20 shenja e ndenjeses se pershtatur ne tribune

.21 shenja e ndihmes komunikuese

1.22 shenja e zones indultive

1.23 shenja e sportelit te pershtatur dhe pulti

1.24 shenja e tabeles se lajmerimeve te pershtatur

1.25 shenja e parkingut te pershtatur

Paraqitja grafike për kushtet e përdorimit të elementeve ndihmëse për arritshmërinë

Kushtet e përdorimit të ndihmesës në hapsira për lëvizje me karroca të personave me aftësi të kufizuara – PAK



Gjerësia e rrugës të levizjes në hapsira të mbyllura.
Gjerësia e rrugës të levizjes në hapsirat e jashtme.
Pamja anësore, pamja ballore, pamja ballore e karrocës së palosur.
Dimensionet në gjerësi të karrocës me shfrytëzues.
Dimensionet mesatare të karrocës së personave me aftësi të kufizuara.

D. SPECIFIKIME PER INSTALIMET E UJESJELLESIT DHE KANALIZIMEVE

1.1 Sistemi i furnizimit me ujë të pastër

1.1.1 Tuba

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave mund të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin e tubave) ose mund të përdoren tuba xingato që janë konform standarteve të mësipërme për cilësinë dhe testimin e tyre. Theksojmë se tubat prej PPR janë afro 15 herë më të lehtë se tubat e çelikut.

Eshte nje tub i perbere nga 3 shtresa per presion pune Pn20bar, me koeficient bymimi 0.030mm/m° C , sipas standartti DIN 8077/78.Ngjyra klasike jeshile me vija me ngjyre me te erret per se gjati.

Ø esterno	mm	20	25	32	40	50	63	75	90	110
Ø interno	mm	13,2	16,6	21,2	26,6	33,2	42	50	60	73,4
Spessore parete	mm	3,4	4,2	5,4	6,7	8,4	10,5	12,5	15	18,3
Peso	kg/m	0,176	0,27	0,444	0,686	1,037	1,689	2,409	3,469	5,04
Contenimento liquido	lt/m	0,13	0,21	0,35	0,55	0,86	1,38	1,96	2,83	4,2

Public Health Sector

Tubat për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe rezistencë ndaj ujit të ngrohtë.

Vetitë e tubave PPR duhet të jenë si më poshtë:

- Densiteti i materialit PPR 0,9 g/cm3
- Pika e ngjitjes 146 gradë celsius
- Konduktiviteti termik në 20 gradë 0,23 W/m.K
- Koefiçienti i zgjerimit termik linear 1,5 x 0,0001 K
- Moduli i elasticitetit në 20 gradë 670 N/mm2
- Sforcimi gjatë rrjedhjes në 20 gradë 22 N/mm2
- Sforcimi i thyerjes në 20 gradë 35 N/mm2

Diametrat e tubave do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të pijshëm dhe shpejtësisë së lëvizjes. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes duhet të merret në intervalet 0,8-1,4 m/sek.

Gjatësia e tubave është 6-12 m, kurse diametri dhe spesori duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj, duhet të jepen të stampuara në çdo tub.

Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë më të grupuara dhe mundësisht sa më afër atyre nyjeve që

kërkojnë ujë të pijshëm. Ato instalohen brenda në mur. Në rast së gjatësia e shtrirjes së tyre është e madhe duhet të vendosen kompesatorë të tipit me brryl të thjeshtë ose tip omega.

Tubat e furnizimit me ujë lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh në çdo kat me anë të tubave të dërgimit. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit duhet të bëhet me tridegëshe ose brryla. Për të pakësuar numrin e kollonave duhet që pajisjet sanitare të grupohen dhe të vendosen njëri mbi tjetrin nga kati në kat të ndërtesës. Diametri i kollonave vertikale të furnizimit me ujë, merret i njëjtë për të gjithë lartësinë e ndërtesës, me diametër më të vogël se tubi kryesor i furnizimit dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i dërgimit të ujit të pijshëm që furnizojnë pajisjet.

Linjat kryesore horizontale të furnizimit me ujë vendosen me pjerrësi ne ngjitje në drejtim të lëvizjes së ujit jo më pak se 2 %. Largësia midis tubave të kanalizimit që dalin tërthor nga godina dhe të lidhjeve të furnizimit me ujë, duhet të jetë jo më pak se 1 m në plan horizontal dhe gjithmonë në kuotë më të lartë se kanalizimet e ujrave të zeza.

Tubat PPR ngjiten me anë të metodës me elektrofuzion duke përdorur pajisjet përkatëse të saldimit me elektrofuzion. Kjo lloj ngjitje garanton një lidhje të sigurtë, homogjene dhe jetëgjatë. Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion zgjat shumë pak minuta. Gjatë këtij proçesi, prerja e tubave, ngrohja e tyre dhe e rakorderive përkatëse PPR bëhet me pajisje të posaçme ngjitjeje. Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion bëhet si më poshtë:

- Bëhet gati pajisja e saldimit me elektrofuzion dhe veglat e duhura për diametrat e përcaktuara të tubave
- Vihet në prizën e energjisë elektrike pajisja e saldimit dhe kontrollohet llampa e ndezjes, si dhe llampa e punës
- Presim sa të kapet temperatura e saldimit prej 260 gradë celsius
- Shënohet thellësia e saldimit me anë të një lapsi konduktiv.
- Nëse tubat, rakorderitë apo pajisja janë të pista bëhet pastrimi i tyre.
- Fillohet proçesi i ngrohjes dhe saldimit të tubave. Koha e ngrohjes, e proçesit të saldimit dhe e ftohjes jepen në tabelat përkatëse të mëposhtme të aparatit të saldimit.

Open Albania
Public Health Sector

Diametri i jashtëm i tubit në mm	Koha e ngrohjes Në sekonda	Koha e proçesit të ngjitjes në sek.	Koha e ftohjes në minuta
16 mm (1/2")	5	4	2
20 mm (3/4")	5	4	2
25 mm (1")	7	4	2
32 mm(1.1/4")	8	6	4
40 mm(1.1/2")	12	6	4
50 mm(1.3/4")	18	6	4
63 mm (2")	24	8	6

- Vendoset fundi i tubit tek vrima e nxehur dhe rakorderia përkatëse në anën tjetër të pajisjes. Fundet përkatëse të tubit dhe rakorderisë përkatëse, pasi lihen të ngrohen, siç është treguar në tabelë, bashkohen në gjendjen e nxehur që janë dhe lihen të ftohen për pak minuta (shih tabelën). Duhet të kihet parasysh që për diametra të ndryshëm ka kohë të ndryshme për ngrohjen, saldimin dhe ftohjen.
- Tubi është i gatshëm për t'u përdorur

Në rast se përdoren tubat e xingatos, lidhja e tyre bëhet me filetim. Gjatë bashkimit, pjesa e filetuar duhet të mbështillet me fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë për të mos patur rrjedhje (qarje).

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

Model i tubit të furnizimit me ujë që do të përdoret së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do t'i jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervisori mund të bëjë testime plotësuese për të dhënat fizike - mekanike- termike të tubave, rrjedhje të mundshme, si dhe presionin që durojnë tubat (Testi i presionit bëhet me 1.5 herë të presionit të punës).

1.1.2 Rakorderitë për tubat e ujit të pijshëm

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesave, në rastet kur do të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen Random), rakorderitë përkatëse duhet të jenë PPR të cilat plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin) ndërsa në tubat xingato rakorderitë janë xingatoje.

Rakorderitë që përdoren në këto linja janë:

- Brrylat të thjeshtë me 45 gradë dhe 90 gradë
- Brryla me fileto metalike të tipit femër dhe mashkull;
- Tridegëshat të thjeshtë dhe me fileto;
- Katërdegësha (Kryqe)
- Bashkues të thjeshtë
- Bashkues me fileto metalike tip femër dhe tip mashkull;
- Reduksionet e ndryshme;
- Rakorderi tip hollandez;
- Mbështetëse;
- Kaluesa;
- Kompensator tip omega;
- Tapa.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Llojet e rakorderive që do të përdoren për çdo rast duhet të jepen nga projektuesi në Vizatimet teknike.

Rakorderitë që do të përdoren për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe rezistencë ndaj ujit të ngrohtë.

Vetitë e rakorderive PPR duhet të jenë si më poshtë:

- Densiteti i materialit PPR 0,9 g/cm3
- Pika e ngjitjes 146 gradë celsius
- Konduktiviteti termik në 20 gradë 0,23 W/m.K
- Koefiçienti i zgjerimit termik linear 1,5 x 0,0001 K
- Moduli i elasticitetit në 20 gradë 670 N/mm2
- Sforcimi gjatë rrjedhjes në 20 gradë 22 N/mm2
- Sforcimi i thyerjes në 20 gradë 35 N/mm2

Diametri dhe spesori duhet t'i përshtaten tubave përkatës dhe të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike dhe kushteve teknike (spesori i rakorderive duhet të jetë i tillë që të përballojë 1,5 herë të presionit të punës së tubave). Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të rakorderive (brryla, tridegësh, bashkues, reduksione, etj), presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo copë.

Rakorderitë PPR ngjiten me anë të metodës me elektrofuzion duke përdorur pajisjet përkatëse të saldimit me elektrofuzion. Kjo lloj ngjitje garanton një lidhje të sigurtë, homogjene dhe jetëgjatë. Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion zgjat shumë pak minuta. Gjatë këtij proçesi, prerja e tubave, ngrohja e tyre dhe e rakorderive përkatëse PPR bëhet me pajisje të posaçme ngjitjeje.

Proçesi i ngjitjes me elektrofuzion bëhet si më poshtë:

- Bëhet gati pajisja e saldimit me elektrofuzion dhe veglat e duhura për diametrat e përcaktuara të tubave;
- Vihet në prizën e energjisë elektrike pajisja e saldimit dhe kontrollohet llampa e ndezjes si dhe llampa e punës
- Presim sa të kapet temperatura e saldimit prej 260 gradë celsius
- Shënohet thellësia e saldimit me anë të një lapsi konduktiv.
- Nëse tubat, rakorderitë apo pajisja janë të pista bëhet pastrimi i tyre.
- Fillohet proçesi i ngrohjes dhe saldimit të tubave dhe rakorderisë së duhur. Koha e ngrohjes, e proçesit të saldimit dhe e ftohjes jepet në tabelat përkatëse të mëposhtme të aparatit të saldimit.

Diametri i jashtëm i tubit në mm	Koha e ngrohjes Në sekonda	Koha e proçesit të ngjitjes në sek.	Koha e ftohjes në minuta
16 mm (1/2")	5	4	2
20 mm (3/4")	5	4	2
25 mm (1")	7	4	2
32 mm(1.1/4")	8	6	4
40 mm(1.1/2")	12	6	4
50 mm(1.3/4")	18	6	4
63 mm (2")	24	8	6

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Vendoset fundi i tubit tek vrima e nxehur dhe rakorderia përkatëse në anën tjetër të pajisjes. Fundet përkatëse të tubit dhe rakorderisë përkatëse, pasi lihen të ngrohen, siç është treguar në tabelë, bashkohen në gjendjen e nxehur që janë dhe lihen të ftohen për pak minuta (shih tabelën). Duhet të kihet parasysh që për diametra të ndryshëm ka kohë të ndryshme për ngrohjen, saldimin dhe ftohjen.

Kur përdoren tubat e xingatos, lidhja e tyre me rakorderitë përkatëse bëhet me filetim. Rakorderitë në këtë rast janë të gjitha metalike me filetim. Gjatë bashkimit, pjesa e filetuar duhet të mbështillet me fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë për të mos patur rrjedhje.

Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit.

